



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 14

Tiranë – E mërkurë, 25 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 96/2022, datë 22.12.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 18, datë 9.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, ‘Për nënshkrimin elektronik’, të ndryshuar”..... 1847
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 32, datë 23.12.2022	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore dhe të maturës shtetërore profesionale 2023..... 1847
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 290, datë 30.12.2022	Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK 1) “Paraqitja e pasqyrave financiare”..... 1850
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 19.1.2023	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar..... 1856
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 4.10.2022	“Çështja Besnik Cani kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 37474/20)..... 1856
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)..... 1878
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 337, datë 21.12.2022	Mbi miratimin e kontratës, ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a., për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike..... 1882
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 338, datë 21.12.2022	Mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”..... 1890
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sotir Papaspiro..... 1906



LIGJ
Nr. 96/2022

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 18,
DATË 9.12.2022, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9880,
DATË 25.2.2008, ‘PËR NËNSHKRIMIN
ELEKTRONIK’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 18, datë 9.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, ‘Për nënshkrimin elektronik’, të ndryshuar”.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 22.12.2022.

UDHËZIM
Nr. 32, datë 23.12.2022

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE DHE TË MATURËS
SHTETËRORE PROFESIONALE 2023**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 51 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7 dhe nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

I. MATURA SHTETËRORE

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2023, për arsimin e mesëm të lartë të jenë:

a) Provime të detyruara: Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj.

b) Një provim me zgjedhje.

2. Provime të detyruara

a) Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj) për të gjithë maturantët/kandidatët janë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

b) Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

c) Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht dhe turqisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

3. Provimi me zgjedhje

a) Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Kimi;
Fizikë;
Biologji;
Histori;
Gjeografi;
Qytetari dhe Psikologji;
Filozofi dhe Sociologji;
Ekonomi;
Histori arti;
Histori muzike;
Histori baleti.

b) Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje, janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

c) Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje.

d) Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

5. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rrijnë atë që të pajisen me diplomë.



6. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2022 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

7. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022), që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të maturave shtetërore para vitit 2014), që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

8. Datat për provimet e Maturës Shtetërore 2023 të jenë:

- a) Gjuhë e huaj: 1 qershor 2023;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 7 qershor 2023;
- c) Matematikë: 13 qershor 2023;
- d) Provimi me zgjedhje: 19 qershor 2023.

9. Provimet e Maturës Shtetërore 2023 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

10. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2023 hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

11. Testi për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2023 vlerësohet me 60 pikë maksimale.

12. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2023, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

13. Zyrtat Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP), pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2022–2023, i pasqyrojnë ato në portalin e Maturës Shtetërore *online*, sipas udhëzimit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

14. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore, sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

15. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*Lingua e letteratura italiana*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatin kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 1 qershor 2023 dhe

zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 1 qershor 2023, para një komisioni të ngritur nga palët.

16. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (DELF B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 26 maj 2023, në shkollat përkatëse.

17. Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2023 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2023.

18. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2023 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në rregulloren e Maturës Shtetërore.

II. MATURA SHTETËRORE PROFESIONALE

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2023, për shkollat e mesme profesionale, janë:

Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar”, sipas kualifikimit profesional që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.

2. Datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2023 të jenë:

- a) Gjuhë e huaj: 1 qershor 2023;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 7 qershor 2023;
- c) Matematikë: 13 qershor 2023;
- d) Teori profesionale e integruar: 19 qershor 2023.

3. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor, që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

4. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022), që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë (të maturave shtetërore para vitit 2014), që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.



5. Lista e provimeve të detyruara të “Teorisë profesionale të integruar”, sipas kualifikimit profesional që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale, është:

Nr.	<i>Kualifikimi profesional</i>
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut
26	Zhvillim <i>Website</i>
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike <i>software</i> -sh (Hermann Gmeiner)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanikë (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji bujqësore
42	Programim
43	Multimedia
44	Administrim zyre

6. Provimet e detyruara “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj e parë”, dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

7. Provimet e detyruara të “Teorisë profesionale të integruar”, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara

në faqet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

8. Kandidati, i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.



9. Kandidati, që në Maturën Shtetërore të viteve 2012–2019:

a) ka zgjedhur “Teorinë profesionale të integruar” dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje.

b) ka zgjedhur “Teorinë profesionale të integruar” dhe rezulton mbetës, duhet të ripajë provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar”, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, te të cilat nuk përfshihet “Teoria profesionale e integruar”, duhet të japë provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar”, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

10. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t’u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provimin e “Teorisë profesionale të integruar” ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

III. DISPOZITATE FUNDIT

1. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore

Profesionale 2023 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit (MAS), zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Sekretari i Përgjithshëm i MAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat arsimore vendore parauniversitare, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit

Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 290, datë 30.12.2022

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË
GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR
TË KONTABILITETIT (SNK 1)
“PARAQITJA E PASQYRAVE
FINANCIARE”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”.

2. Ndryshimet e SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” kanë datë efektive 1 janar 2024.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj



DETYRIMET AFATGJATA ME PREMTIME KUFIZUESE Ndryshime në SNK 1

Ndryshime në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*

Janë ndryshuar paragrafët 60, 71, 72A, 74 dhe 139U. Janë shtuar paragrafët 72B dhe 139W. Menjëherë pas paragrafit 76 është shtuar paragrafi 76ZA. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafët 69 dhe 75 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Struktura dhe përmbajtja

...

Pasqyra e pozicionit financiar

...

Dallimi afatshkurtër /afatgjatë

- 60 Njësia ekonomike duhet të paraqesë aktivet afatshkurtra dhe afatgjata dhe detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata si klasifikime të veçanta në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me paragrafët 66–76B, përveç kur një paraqitje e bazuar në likuiditetin siguron informacion që është i besueshëm dhe më i rëndësishëm. Nëse ky përjashtim zbatohet, të gjitha aktivet dhe detyrimet duhet të paraqiten sipas nivelit të likuiditetit.

...

Detyrimet afatshkurtra

- 69 Njësia ekonomike do ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:
- (a) pret të shlyejë detyrimin gjatë ciklit normal të shfrytëzimit;
 - (b) e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtare;
 - (c) detyrimi duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit; ose
 - (d) nuk ka të drejtë në fund të periudhës raportuese për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit.

Njësia ekonomike do t'i klasifikojë të gjitha detyrimet e tjera si afatgjata.

...

I mbajtur kryesisht për tregtim (paragrafi 69(b)) ose duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve (paragrafi 69(c))

- 71 Detyrimet e tjera afatshkurtra që nuk janë shlyer gjatë ciklit normal të shfrytëzimit por që duhet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit, ose që mbahen kryesisht për qëllime tregtare. Shembuj janë disa detyrime financiare që plotësojnë përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9, overdraftet (llogaritë e zbuluara) bankare dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare, dividendët e pagueshëm, tatimi mbi të ardhurat dhe të pagueshme të tjera jo tregtare. Detyrimet financiare që sigurojnë financim mbi një bazë afatgjatë (d.m.th. nuk janë pjesë e kapitalit qarkullues të përdorur gjatë ciklit normal të shfrytëzimit të njësive ekonomike) dhe që nuk kërkohet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit janë detyrime afatgjata, objekt i paragrafëve 72A–75~~74~~ dhe 75.

...

E drejta për ta shtyrë shlyerjen për të paktën dymbëdhjetë muaj (paragrafi 69(d))

- 72A E drejta e një njësie ekonomike për ta shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës raportuese duhet të jetë thelbësore dhe duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit, siç ilustron paragrafët 72B–75~~73–75~~. Nëse e drejta për të shtyrë shlyerjen është objekt i pajtueshmërisë



me kushte specifike nga ana e njësive ekonomike, e drejta ekziston në fund të periudhës së raportimit vetëm nëse njësia ekonomike është në pajtim me ato kushte në fund të asaj periudhe. Njësia ekonomike duhet të jetë në pajtim me kushtet në fund të periudhës së raportimit edhe nëse huadhënësi nuk e teston pajtueshmërinë e tyre deri në një datë të mëvonshme.

72B E drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi që vjen nga një marrëveshje huaje për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit mund të jetë subjekt i plotësimit të kushteve nga ana e njësive ekonomike të cilësuar në atë marrëveshje huaje (referuar si 'premtim kufizues' këtu e në vijim). Me qëllim zbatimin e paragrafit 69(d), premtime kufizuese të tilla:

(a) ndikojnë nëse ajo e drejtë ekziston në fund të periudhës raportuese—siç ilustron në paragrafët 74–75—nëse një njësi ekonomike duhet të plotësojë premtimin kufizues në fund të periudhës raportuese apo më parë. Një premtim kufizues i tillë ndikon nëse e drejta ekziston në fund të periudhës raportuese edhe nëse pajtueshmëria me premtimin kufizues vlerësohet vetëm pas periudhës raportuese (për shembull, një premtim kufizues i bazuar në pozicionin financiar të njësive ekonomike në fund të periudhës raportuese, por i vlerësuar për pajtueshmëri vetëm pas periudhës raportuese).

(b) nuk ndikojnë nëse ajo e drejtë ekziston në fund të periudhës raportuese nëse njësia ekonomike duhet të plotësojë premtimin kufizues vetëm pas periudhës raportuese (për shembull një premtim kufizues i bazuar në pozicionin financiar të njësive ekonomike gjashtë muaj pas fundit të periudhës së raportimit).

...

74 Nëse një njësi ekonomike shkel një premtim kufizues kushtlidhur me një marrëveshje huaje afatgjatë në ose përpara fundit të periudhës raportuese, me efekte që detyrimi bëhet i pagueshëm në të parë, detyrimi klasifikohet si afatshkurtër edhe nëse huadhënësi ka rënë dakord pas periudhës së raportimit dhe para autorizimit për publikimin e pasqyrave financiare, të mos kërkojë shlyerjen e huasë si pasojë e shkeljes. Njësia ekonomike e klasifikon detyrimin si afatshkurtër, sepse në fund të periudhës së raportimit ajo nuk ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e tij për të paktën dymbëdhjetë muaj pas asaj date.

75 Por detyrimi klasifikohet si afatgjatë nëse huadhënësi ka rënë dakord që në fund të periudhës raportuese të ofrojë një periudhë faljeje, e cila përfundon të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit dhe brenda të cilës njësia ekonomike mund të korrigjojë shkeljen dhe gjatë së cilës huadhënësi nuk mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme.

...

76ZA Kur zbaton paragrafët 69–75, njësia ekonomike mund të klasifikojë detyrimet që vijnë nga marrëveshjet e huasë si afatgjata nëse e drejta e njësive ekonomike për të shtyrë shlyerjen e huave është subjekt i plotësimit të premtimeve kufizuese nga njësia ekonomike brenda dymbëdhjetë muajve nga periudha e raportimit (shih paragrafin 72B(b)). Në rrethana të tilla, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në shënimet e pasqyrave për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë rrezikun se detyrimet mund të bëhen për t'u paguar brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit, duke përfshirë:

(a) informacion mbi premtimet kufizuese (përfshirë natyrën e premtimeve kufizuese dhe se kur njësia ekonomike duhet t'i plotësojë ato) dhe vlerën kontabël (neto) të detyrimeve përkatëse.

(b) fakte dhe rrethana, nëse ka, që tregojnë se njësia ekonomike mund të ketë vështirësi në plotësimin e premtimeve kufizuese—për shembull, njësia ekonomike ka vepruar gjatë ose pas periudhës së raportimit për të shmangur apo zbutur një shkelje të mundshme. Gjithashtu, të tilla fakte dhe rrethana mund të përfshijnë faktin që njësia ekonomike nuk do të kishte plotësuar premtimet kufizuese nëse ato do të ishin vlerësuar mbi pajtueshmërinë bazuar në rrethanat e njësive ekonomike në fund të periudhës së raportimit.

...

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

139U Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtër ose Afatgjatë, i publikuar në janar 2020 ndryshoi paragrafët 69, 73, 74 dhe 76, si dhe shtoi paragrafët 72A, 75A, 76A dhe 76B. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2024. 1 janar 2023 ose pas kësaj date në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse njësia ekonomike i zbaton



këto ndryshime për një periudhë më të hershme se publikimi i *Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese* (shih paragrafin 139W), ajo duhet të zbatojë edhe *Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese* për atë periudhë. Nëse njësi ekonomike zbaton *Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtër ose Afatgjatë* ~~këto ndryshime~~ për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

...

139W *Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese*, i publikuar në tetor 2022, ndryshoi paragrafët 60, 71, 72A, 74 dhe 139U, si dhe shtoi paragrafët 72B dhe 76ZA. Njësi ekonomike do të zbatojë:

- (a) ndryshimin në paragrafin 139U menjëherë me publikimin e *Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese*.
- (b) të gjitha ndryshimet e tjera për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2024 ose pas kësaj date në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të zbatojë edhe *Klasifikimin e Detyrimeve si Afatshkurtër ose Afatgjatë* për atë periudhë. Nëse njësi ekonomike zbaton *Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese* për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.



Non-current Liabilities with Covenants

Amendments to IAS 1

Amendments to IAS 1 *Presentation of Financial Statements*

Paragraphs 60, 71, 72A, 74 and 139U are amended. Paragraphs 72B and 139W are added. Paragraph 76ZA is added immediately after paragraph 76. New text is underlined and deleted text is struck through. Paragraphs 69 and 75 are not amended but have been included for ease of reference.

Structure and content

...

Statement of financial position

...

Current/non- current distinction

- 60 An entity shall present current and non-current assets, and current and non-current liabilities, as separate classifications in its statement of financial position in accordance with paragraphs 66–76B except when a presentation based on liquidity provides information that is reliable and more relevant. When that exception applies, an entity shall present all assets and liabilities in order of liquidity.

...

Current liabilities

- 69 An entity shall classify a liability as current when:
- (a) it expects to settle the liability in its normal operating cycle;
 - (b) it holds the liability primarily for the purpose of trading;
 - (c) the liability is due to be settled within twelve months after the reporting period; or
 - (d) it does not have the right at the end of the reporting period to defer settlement of the liability for at least twelve months after the reporting period.

An entity shall classify all other liabilities as non-current.

...

Held primarily for the purpose of trading (paragraph 69(b)) or due to be settled within twelve months (paragraph 69(c))

- 71 Other current liabilities are not settled as part of the normal operating cycle, but are due for settlement within twelve months after the reporting period or held primarily for the purpose of trading. Examples are some financial liabilities that meet the definition of held for trading in IFRS 9, bank overdrafts, and the current portion of non-current financial liabilities, dividends payable, income taxes and other non-trade payables. Financial liabilities that provide financing on a long-term basis (ie are not part of the working capital used in the entity's normal operating cycle) and are not due for settlement within twelve months after the reporting period are non-current liabilities, subject to paragraphs 72A–75–74 and ~~75~~.

...

Right to defer settlement for at least twelve months (paragraph 69(d))

- 72A An entity's right to defer settlement of a liability for at least twelve months after the reporting period must have substance and, as illustrated in paragraphs 72B–75–73–75, must exist at the end of the reporting period. ~~If the right to defer settlement is subject to the entity complying with specified conditions, the right exists at the end of the reporting period only if the entity complies with these conditions at the end of the~~



reporting period. The entity must comply with the conditions at the end of the reporting period even if the lender does not test compliance until a later date.

72B An entity's right to defer settlement of a liability arising from a loan arrangement for at least twelve months after the reporting period may be subject to the entity complying with conditions specified in that loan arrangement (hereafter referred to as 'covenants'). For the purposes of applying paragraph 69(d), such covenants:

(a) affect whether that right exists at the end of the reporting period—as illustrated in paragraphs 74–75—if an entity is required to comply with the covenant on or before the end of the reporting period. Such a covenant affects whether the right exists at the end of the reporting period even if compliance with the covenant is assessed only after the reporting period (for example, a covenant based on the entity's financial position at the end of the reporting period but assessed for compliance only after the reporting period).

(b) do not affect whether that right exists at the end of the reporting period if an entity is required to comply with the covenant only after the reporting period (for example, a covenant based on the entity's financial position six months after the end of the reporting period).

...

74 When an entity breaches a covenant condition of a long-term loan arrangement on or before the end of the reporting period with the effect that the liability becomes payable on demand, it classifies the liability as current, even if the lender agreed, after the reporting period and before the authorisation of the financial statements for issue, not to demand payment as a consequence of the breach. An entity classifies the liability as current because, at the end of the reporting period, it does not have the right to defer its settlement for at least twelve months after that date.

75 However, an entity classifies the liability as non-current if the lender agreed by the end of the reporting period to provide a period of grace ending at least twelve months after the reporting period, within which the entity can rectify the breach and during which the lender cannot demand immediate repayment.

...

76ZA In applying paragraphs 69–75, an entity might classify liabilities arising from loan arrangements as non-current when the entity's right to defer settlement of those liabilities is subject to the entity complying with covenants within twelve months after the reporting period (see paragraph 72B(b)). In such situations, the entity shall disclose information in the notes that enables users of financial statements to understand the risk that the liabilities could become repayable within twelve months after the reporting period, including:

(a) information about the covenants (including the nature of the covenants and when the entity is required to comply with them) and the carrying amount of related liabilities.

(b) facts and circumstances, if any, that indicate the entity may have difficulty complying with the covenants—for example, the entity having acted during or after the reporting period to avoid or mitigate a potential breach. Such facts and circumstances could also include the fact that the entity would not have complied with the covenants if they were to be assessed for compliance based on the entity's circumstances at the end of the reporting period.

...

Transition and effective date

...

139U *Classification of Liabilities as Current or Non-current*, issued in January 2020 amended paragraphs 69, 73, 74 and 76 and added paragraphs 72A, 75A, 76A and 76B. An entity shall apply those amendments for annual reporting periods beginning on or after 1 January 2024 ~~1 January 2023~~ retrospectively in accordance with IAS 8. Earlier application is permitted. If an entity applies those amendments for an earlier period after the issue of *Non-current Liabilities with Covenants* (see paragraph 139W), it shall also apply *Non-current Liabilities with Covenants* for that period. If an entity applies *Classification of Liabilities as Current or Non-current* these amendments for an earlier period, it shall disclose that fact.

...

139W *Non-current Liabilities with Covenants*, issued in October 2022, amended paragraphs 60, 71, 72A, 74 and 139U and added paragraphs 72B and 76ZA. An entity shall apply:

(a) the amendment to paragraph 139U immediately on issue of *Non-current Liabilities with Covenants*.

(b) all other amendments for annual reporting periods beginning on or after 1 January 2024 retrospectively in accordance with IAS 8. Earlier application is permitted. If an entity applies these amendments for an earlier period, it shall also apply *Classification of Liabilities as Current or Non-current* for that period. If an entity applies *Non-current Liabilities with Covenants* for an earlier period, it shall disclose that fact.



UDHËZIM

Nr. 3, datë 19.1.2023

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN
NR. 23, DATË 9.12.2014, “PËR
MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimet e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, pika 10, paragrafi 10.8, “Të tjera”, bëhen shtesa, si më poshtë vijon:

1. Pas kategorisë 33 shtohen kategoritë 34, 35, 36, 37 dhe 38 me përmbajtje, si më poshtë vijon:

– Kategoria 34. Person i papunë (grua) me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (mijë lekë në muaj).

- Kategoria 35. Kujdestar i personit invalid paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

- Kategoria 36. I vetëpunësuar i vetëm që është përfitues i pensionit të pleqërisë.

- Kategoria 37. Person i trajtuar me pagesë kalimtare, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar.

- Kategoria 38. Person i papunë që përfiton pagesë papunësie.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA BESNIK CANI
KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 37474/20)

VENDIM

Neni 6 § 1 (civil) – Gjykatë e krijuar me ligj – Pretendim i argumentueshëm për shkelje të qartë të rregullit themelor vendës, duke ndikuar në mënyrë të pafavorshme në caktimin e një gjyqtari në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA) i mbledhur si panel, i cili rivlerësoi dhe shkarkoi nga detyra një prokuror – Kërkesa për një kontroll me tre hapa në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* [DHM] – Asnjë deklaratë e qartë dhe autoritare nga gjykatat vendëse, në lidhje me shkeljen e qartë të ligjit vendës – Autoritetet nën detyrimin për verifikimin e respektimit të kriterëve statutorë të përzgjedhshmërisë nga gjyqtarët e KPA-së – Asnjë shqyrtim dhe zgjidhje efikase nga gjykata vendëse

Neni 46 – Masa individuale – Riçelja e procesit të rivlerësimit, me kërkesë të ankuesit dhe rishqyrtimi i çështjes në mbështetje të kërkesave të nenit 6 § 1

STRASBURG
4 tetor 2022

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë, sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Georges Ravarani, *kryetar*,
Georgios A. Serghides,
María Elósegui,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,



Andreas Zünd,
Frédéric Krenc, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit*,
duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 37474/20) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z. Besnik Cani (“ankuesi”), më 25 gusht 2020;

vendimin për të vënë në dijeni Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) për një pjesë të ankesave bërë në mbështetje të nenit 6 § 1, nenit 8 dhe nenit 13 të Konventës, dhe për ta shpallur të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

vërejtjet e paraqitura nga Qeveria përgjegjëse dhe vërejtjet e paraqitura si përgjigje ndaj të parave nga ankuesi;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 13 shtator 2022,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Kërkuesi është një ish-prokuror dhe çështja ka të bëjë me ankesën e tij mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, që e shkarkoi nga detyra e tij e mëparshme, nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj”, duke pasur parasysh se njëri prej gjyqtarëve, i cili e shqyrtoi çështjen e tij ishte caktuar në atë pozicion në shkelje të kriterit statutor të përzgjedhshmërisë.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1970 dhe banon në Tiranë. Ai u përfaqësua përpara Gjykatës nga z. E. Halimi, një avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Tiranë.

3. Fillimisht, Qeveria u përfaqësua nga ish-agjentja e saj, znj. B. Lilo, dhe më pas, nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

I. KUADRI I PROCEDURAVE TË RIVLERËSIMIT (VETTING-UT) NË SHQIPËRI

A. Kuadri i përgjithshëm

5. Në vitin 2016, Shqipëria ndërmoi një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, reformë e cila çoi në ndryshimet e Kushtetutës dhe në miratimin e një sërë ligjeve në lidhje me, midis të tjerash, rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe

prokurorëve në detyrë, dhe të disa këshilltarëve/ndihmësve ligjorë (referuar ndryshe si “procesi i vetting-ut”) (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë* nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021). Parashikimet më të rëndësishme në lidhje me procesin e vetting-ut u përfshinë në një aneks në Kushtetutë.

6. Procesi i vetting-ut/rivlerësimit do të realizohej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) në shkallë të parë, dhe – në rastin e një apelimi – nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (“KPA”) pranë Gjykatës Kushtetuese (të cilat së bashku referohen si “organet e vetting-ut”). Shtetasit shqiptarë, të cilët, midis kushteve të tjera, nuk kishin qenë subjekt i masës disiplinore të largimit nga detyra, ose të cilët nuk kishin qenë subjekt i një mase tjetër disiplinore që ishte ende në fuqi, mund të emëroheshin si anëtarë të organeve të vetting-ut (po aty, §123; shih edhe paragrafin 50 më poshtë). Në vijim të procesit të përzgjedhjes paraprake të ndërmarrë nga Presidenti i Republikës (ose në raste të caktuara nga Avokati i Popullit), kandidatët do të intervistoheshin dhe në vijim do të emëroheshin nga Parlamenti.

7. KPK-ja dhe KPA-ja do të rivlerësonin të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë në bazë të tri kriterëve: i. vlerësimi i pasurisë së tyre personale; ii. kontrolli i figurës dhe i integritetit me synimin që të identifikoheshin lidhje të mundshme me krimin e organizuar; dhe iii. vlerësimi i ekspertizës së tyre profesionale. Komisioneri Publik do të përfaqësonte interesin publik përpara organeve të vetting-ut; Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (“ONM”) i udhëhequr nga Komisioni Evropian dhe i përbërë nga vëzhgues ndërkombëtarë do të mbështeste, monitoronte dhe mbikëqyrte procesin e rivlerësimit. Në përfundim të secilit grup të procedurave të rivlerësimit, organet e vetting-ut do të jepnin vendime të arsyetuara, të cilat konfirmonin në detyrë ose pezullonin ose shkarkonin nga detyra personin e vlerësuar.

B. Emërimet dhe shkarkimet nga detyra të gjyqtarit L.D.

1. Emërimi dhe shkarkimi nga detyra si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë

8. Më 24 prill 1994, L.D. u emërua si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë. Më 24 dhjetor 1997, Këshilli i Lartë Gjyqësor (“KLGJ”), i cili në periudhën në fjalë ishte organi që emëronte dhe shkarkonte gjyqtarët, shkarkoi L.D. nga detyra e tij për shkelje të ligjit dhe për paaftësi në detyrë.



9. Pas një thirrje të hapur për rekrutimin e pesë gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Tiranë, dhe pas aplikimit të L.D. për njërin prej pozicioneve, më 5 nëntor 2016, KLGJ-ja vendosi ta skualifikonte L.D. nga konkursi me arsyetimin se ai ishte shkarkuar nga i njëjti pozicion më 24 dhjetor 1997.

2. Emërimi dhe shkarkimi i L.D. nga KPA-ja

10. Si përgjigje ndaj një thirrje publike për shprehje të interesit të lëshuar nga Avokati i Popullit, më 3 shkurt 2017, L.D. paraqiti një aplikim ku shprehte interesin e tij për, midis vakancave të tjera, pozicionin si gjyqtar i KPA-sa. Në aplikimin e tij, L.D. listonte kriteret kryesore për përzgjedhje në atë pozicion dhe pohonte se i përmbushte që të gjitha ato. Veçanërisht, në aplikimin e tij, ai deklaronte, si më poshtë:

“... kundër meje nuk është ndërmarrë ndonjë masë disiplinore për shkarkim nga detyra apo ndonjë masë disiplinore që është ende në fuqi, sipas ligjit të zbatueshëm në periudhën e aplikimit [tëm për pozicionin e gjyqtarit të KPA-së].”

11. Pas krijimit nga Avokati i Popullit të një komisioni *ad hoc*, i cili do të shqyrtonte të gjitha aplikimet e marra për pozicionet në organet e *vetting*-ut, më 13 shkurt 2017, ky komision dhe ONM-ja miratuan një protokoll për metodën, sipas së cilës do të vlerësohej përmbushja e kriterëve statutorë për përzgjedhshmërinë nga kandidatët. Për sa ka të bëjë me situatën, protokollin parashikonte se një vetëdeklarim nga ana e kandidatëve do të ishte mjaftueshëm të konsiderohej se një kandidat nuk kishte qenë “subjekt i masës disiplinore për shkarkim nga detyra apo i ndonjë mase tjetër disiplinore, e cila kishte qenë ende në fuqi në kohën e aplikimit”, për një pozicion në njërin prej organeve të *vetting*-ut, sipas parashikimit në nenin 6(1)(dh) të ligjit të rivlerësimit (shih paragrafin 50 më poshtë).

12. Pas një sërë komunikimesh midis Avokatit të Popullit, ONM dhe Parlamentit, në fund Avokati i Popullit paraqiti në Parlament një listë me kandidatët, të cilët përmbushnin kriteret statutorë të përzgjedhshmërisë. Lista përfshinte edhe L.D.

13. Më 2 qershor 2017, një komision i posaçëm në Parlament zhvilloi një seancë gjatë së cilës intervistoi L.D. dhe kandidatët e tjerë për organet e *vetting*-ut. Njëri prej anëtarëve të komisionit e pyeti L.D., nëse ishte shkarkuar nga detyra apo nëse ishte dorëhequr nga pozicioni i

tij i mëparshëm si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë. L.D. u përgjigj se ishte dorëhequr.

14. Me anë të vendimit nr. 82/2017, të datës 17 qershor 2017, Parlamenti konfirmoi *en block* listën e anëtarëve të organeve të *vetting*-ut, ku L.D. emërohej si gjyqtar i KPA-së.

15. Më 17 janar 2020, teksa procedurat për rivlerësimin e ankuesit ishin në vijim përpara KPA-së (shih paragrafët 33–34 më poshtë), kërkuesi paraqiti një padi penale në lidhje me L.D. Padia i referohej shkarkimit të L.D. në vitin 1997 nga detyra si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë (shih paragrafin 8 më sipër), dhe pretendonte se L.D. ishte përfshirë në “falsifikim dokumentesh”, duke dorëzuar përpara Avokatit të Popullit një aplikim ku deklarohet se ai nuk ishte shkarkuar asnjëherë nga ndonjë detyrë (shih paragrafin 10 më sipër). Pas një vendimi të miratuar nga prokuroria, më 15 korrik 2020, ku L.D. akuzohej për falsifikim dokumentesh, më 24 korrik 2020, KPA-ja vendosi ta pezullonte L.D. nga detyra e tij si gjyqtar i KPA-së.

16. Pas konfirmimit nga Gjykata e Lartë e dënimit të L.D. për veprën në fjalë (shih paragrafin 27 më poshtë), më 31 maj 2021, komisioni disiplinor i KPA (“Komisioni Disiplinor”) – i cili është organi me autoritetin për të marrë një vendim, në lidhje me shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët e KPA-së – shkarkoi L.D. nga detyra e tij si gjyqtar i KPA-së. Komisioni Disiplinor iu referua nenit 128 § 2 (b) të Kushtetutës, duke konstatuar se L.D. dënohej për një shkelje disiplinore, gjë që e bënte të papërshtatshëm për të vijuar që të mbante detyrën si gjyqtar i KPA-së. Si përgjigje ndaj argumentit të L.D. se dënimi i tij ishte në kundërshtim me ligjin, Komisioni Disiplinor theksoi se juridiksioni i tij shkonte deri në pikën ku shtrohej pyetja nëse L.D. kishte qenë dënuar apo jo, dhe se ai nuk mund të dëgjonte argumentet në lidhje me meritat e dënimit.

C. Procesi penal ndaj L.D.

1. Vendimi i shkallës së parë

17. Në aktakuzën e saj ndaj L.D., prokuroria parashittoi, për sa ka të bëjë me çështjen, se sipas ligjit vendës vetëm kandidatët të cilët nuk kishin qenë shkarkuar më herët nga detyra mund të emëroheshin si gjyqtarë të KPA-së. Në vijim, argumentohej se L.D. kishte paraqitur një aplikim të falsifikuar përpara autoriteteve vendëse, në kundërshtim me nenin 186 § 1 të Kodit Penal;



falsifikimi kishte të bënte me një deklaratë me shkrim ku pohohej se ai nuk ishte shkarkuar kurrë nga ndonjë detyrë.

18. L.D. e mohoi akuzën. Ai parashtroi se masa disiplinore kundër tij në vitin 1997 ishte hequr nga të dhënat e tij (ishte shuar) në mbështetje të nenit 33(6) të ligjit për gjyqësorin të vitit 2008 (ligji nr. 9877/2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar) (shih paragrafin 55 më poshtë), i cili, sipas mendimit të tij, parashikonte se masat disiplinore, në lidhje me shkeljet e rënda do të hiqeshin nga të dhënat e gjyqtarit në fjalë brenda tri viteve, nëse gjatë asaj periudhe nuk ishte dhënë asnjë masë tjetër disiplinore.

19. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e shpalli L.D. fajtor për falsifikim dokumentesh dhe e dënoi me gjashtë muaj burgim, pezulluar për dymbëdhjetë muaj.

20. Gjykata vlerësoi se në mbështetje me ligjin vendës, një kandidat skualifikohet nga mbajtja e pozicionit si gjyqtar i KPA-së, nëse ai/a jo ka qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pavarësisht datës se kur është dhënë ajo masë.

21. Në vijim, gjykata vlerësoi se në mbështetje të nenit 6(1) (dh) të ligjit për rivlerësimin, nëse një kandidat kishte qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, kjo nënkuptonte se kandidati nuk përmbushte kushtet statutores për emërimin në pozicionin si gjyqtar i KPA-së.

22. Si përgjigje ndaj argumentit të L.D., se masa kundër tij ishte hequr nga të dhënat e tij, gjykata vlerësoi se neni 32(1) i vitit 2008 i ligjit për pushtetin gjyqësor, parashikonte tri lloje të masave disiplinore, më konkretisht: i. masat më pak të rënda; ii. masat e rënda; dhe iii. masat shumë të rënda. Sipas gjykatës, neni 33(6) i vitit 2008 në ligjin për pushtetin gjyqësor parashikonte, se të gjitha masat disiplinore *më pak të rënda* dhe *të rënda* do të fshiheshin nga të dhënat pas përfundimit të afateve kohore përkatëse; megjithatë, neni nuk parashikonte fshirjen e masave disiplinore *shumë të rënda*, të tilla si shkarkimi nga detyra. Gjithashtu, gjykata citonte nenin 150 § 3 të ligjit për statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar – shih paragrafin 54 më poshtë), i cili e trajtonte çështjen pas shfuqizimit të ligjit për pushtetin gjyqësor të vitit 2008, duke parashikuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk mund

të fshihej nga të dhënat e një gjyqtari. Për këtë arsye, gjykata arriti në përfundimin se masa disiplinore e vitit 1997 kundër L.D. nuk ishte fshirë nga të dhënat e tij.

23. Së fundmi, gjykata pohon edhe se L.D. do të ishte skualifikuar nga emërimi si gjyqtar i KPA-së, nëse shkarkimi i tij nga detyra në vitin 1997 do t'i ishte bërë i ditur autoriteteve vendëse.

2. Vendimi i shkallës së dytë

24. Pas apelimit të paraqitur nga L.D., më 8 mars 2021, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar la në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke përsëritur në thelb të njëjtat arsye.

25. Gjykata e Apelit përsëriti në veçanti, se:

“Përmbajtja e kërkesës [paraqitur nga L.D. për një pozicion në KPA] në këtë çështje është e rëndësishme dhe ka pasoja, pasi mospërmbushja e kriterëve formale të parashikuara [në nenin 6(1) të ligjit të *vetting*-ut] çon në skualifikimin e kandidatit / aplikantit. Ky rregull demonstroi rëndësinë që ligjbërësi u ka veshur këtyre kriterëve, të cilat kanë lidhje me cilësitë personale që duhet të ketë një aplikues/kandidat për t'u emëruar në institucionet [që mbikëqyrin] rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Këto cilësi/kritere, [që] parashikohen me ligj, janë të rëndësishme kur citohen përpara një institucioni publik – veçanërisht në çështjen konkrete, ku i gjithë procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me besimin publik në [sistemin] e drejtësisë (që është qëllimi për krijimin e këtyre institucioneve).”

26. Gjithashtu, Gjykata e Apelit vlerësoi, se:

“... fakti që organet e fuqizuara me ligj për kontrollin e kandidatëve për në institucionet kalimtare të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve nuk kanë kryer kontrollet përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore [...], nuk përjashton përgjegjësinë e të pandehurit, i cili, në mënyrë të qëllimshme dhe me dijeni të plotë ka paraqitur në aplikimin e tij një rrethanë false, duke fshehur [në këtë mënyrë] një kusht skualifikues lidhur me ekzistencën e një mase disiplinore për heqje/shkarkim nga detyra të vendosur ndaj tij.”

3. Vendimi i Gjykatës së Lartë

27. Më 26 tetor 2021, Gjykata e Lartë e rrëzoi si të papranueshëm apelimin e paraqitur nga L.D., dhe në thelb la në fuqi arsyetimin dhe përfundimet e gjykatave më të ulëta.



28. Gjykata e Lartë vlerësoi se një shkarkim i mëparshëm nga detyra e skualifikonte një kandidat nga mbajtja e funksioneve të caktuara publike, dhe konfirmoi se masat disiplinore për shkeljet shumë të rënda nuk fshiheshin nga të dhënat e një gjyqtari me kalimin e kohës. Në vijim, gjykata konstatoi, se:

“69... [L.D.] ka ofruar qëllimisht informacione false në aplikimin e tij për pozicionin e gjyqtarit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pozicion për të cilin [sipas vlerësimit] u kualifikua dhe [më pas] u emërua, pikërisht për shkak të informacioneve të pavërteta që kishte paraqitur në formularin e aplikimit. Nëse kërkuesi [L.D.] do të kishte paraqitur në aplikimin e tij edhe shkarkimin e tij nga detyra në vitin 1997, ai do të kishte rrezikuar të skualifikohej sipas ligjit [që të merrej në konsideratë] për pozicionet [në organet e *vetting*-ut].

70. Mosverifikimi nga ana e organeve përkatëse, në mbështetje të ligjit nr. 84/2016 ... i kushteve që duhej të përmbusheshin nga kandidatët për pozicionet në organet e *vetting*-ut, nuk e përjashton kërkuesin nga përgjegjësia për deklarimin e informacioneve të pavërteta në aplikimin e tij.”

29. Në vijim, Gjykata e Lartë deklaronte, se:

“78. Është e kuptueshme se ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve ... në përcaktimin e kriterëve të parashikuara në nenin 6, synonte të emëronte ... në institucionet e rivlerësimit [njerëz] të cilët gëzonin moral dhe integritet profesional të lartë.”

30. Një gjyqtar shtoi një opinion mospajtues, i cili argumentonte se aplikimi i L.D. për pozicionin e gjyqtarit në KPA ishte thjesht një dokument privat, i cili nuk mund të ishte objekt i falsifikimit; më tej ai parashtroi se, në çdo rast, mbrojtja e L.D. se ai kishte besuar se masa disiplinore ishte fshirë nga të dhënat e tij ishte e argumentueshme, dhe për këtë arsye, nga rrethanat e çështjes nuk mund të konkludohej për ndonjë qëllim kriminal.

31. Në opinionin e gjyqtarit kundërshtues, gjykatat penale nuk ishin kompetente për të bërë një përcaktim përfundimtar se shkarkimi nga detyra i L.D. në vitin 1997 e skualifikonte atë nga mundësia që të mbante pozicionin e gjyqtarit në KPA; për më tepër, edhe nëse supozohej se shkarkimi i vitit 1997 e kishte skualifikuar L.D., emërimi i tij si gjyqtar i KPA-së ishte bërë i mundur vetëm fal mosverifikimit nga ana e Avokatit të Popullit dhe e Parlamentit, nëse ai i kishte

përmbushur kriteret përkatëse (dhe jo fal aplikimit që L.D. kishte paraqitur pranë Avokatit të Popullit).

II. PROCEDURAT E *VETTING*-UT NË LIDHJE ME KËRKUESIN

A. Procedurat në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

32. Në vitin 2003, kërkuesi u emërua në detyrën e prokurorit. Me hyrjen në fuqi të ligjit të *vetting*-ut/rivlerësimit në vitin 2016 dhe pas emërimit të tij si anëtar i organit drejtues të prokurorisë (më konkretisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë), kërkuesi u vendos në listën e personave që do të rivlerësoheshin/vetoheshin me prioritet.

33. Më 27 nëntor 2018, KPK-ja konfirmoi kërkuesin në detyrën e tij. KPK-ja konstatoi se kërkuesi nuk kishte fshehur pasurinë: Komisioni faktikisht, gjeti një numër pasaktësish në deklaratat e tij të përvitshme të pasurisë, dhe kërkuesi nuk mund të demonstronte burimin e ligjshëm të shumave të ndryshme që në total ishin 819,812 lekë shqiptarë (ALL – rreth 6800 euro (EUR)), që i kishte marrë gjatë një periudhe njëmbëdhjetë-vjeçare; megjithatë, në gjykimin e KPK-së, përmasa e atyre shumave ishte e pamjaftueshme për të justifikuar përjashtimin e tij. Gjithashtu, KPK-ja arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte pasur kontakte të papërshtatshme me individë të përfshirë në krimin e organizuar dhe se nuk ishte konstatuar asnjë çështje problematike gjatë kontrollit të figurës së tij. Së fundmi, KPK-ja konstatoi se kishte disa rrethana që vinin në pikëpyetje profesionalizmin dhe etikën e kërkuesit; megjithatë, ato rrethana nuk përbënin shkaqe të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kërkuesi nuk përmbushte standardet minimale profesionale ose të etikës. Në përputhje me rrethanat, KPK-ja i referoi ato çështje pranë organit përgjegjës për shkelje disiplinore, për verifikim të mëtejshëm.

34. Pas apelimit nga ana e Komisionerit Publik kundër vendimit të KPK-së, çështja iu kalua KPA-së, e cila u mblodh si një trup gjykues i përbërë nga pesë gjyqtarë (duke përfshirë edhe L.D.).

B. Procedurat përpara KPA-së

35. Më 17 janar 2020, kërkuesi – me pretendimin, ndër të tjera, se L.D. ishte emëruar në KPA pavarësisht faktit se nuk kishte përmbushur kërkesat statutores të përzgjedhshmërisë (shih paragrafin 8 më sipër dhe paragrafin 50 më poshtë) – paraqiti kërkesën, që KPA-ja ta ndërpriste



përfundimisht mandatin e L.D. (“kërkesa e parë”). Në po të njëjtën datë, kërkuesi paraqiti një padi penale kundër L.D. me pretendimin për falsifikim dokumentesh (shih paragrafin 15 më sipër). Më 3 shkurt 2020, kryetari i KPA-së iu përgjigj ankuesit me anë të një letre, ku theksohej se KPA-ja nuk kishte juridiksionin për shqyrtimin e kërkesës për sa kishte të bënte me zhvillimet që kishin ndodhur përpara emërimit të L.D. si gjyqtar i KPA (*nuk ka kompetencë dhe juridiksionin për shqyrtimin e kërkesës suaj ... pasi pretendimet tuaja i përjashtojnë periudhën përpara emërimit të [L.D.] në funksionin e anëtarit të Kolegjit*).

36. Sakaq, më 20 janar 2020, kërkuesi paraqiti një tjetër kërkesë pranë KPA-së në mbështetje të të njëjtave fakte dhe argumente mbi të cilat ishte mbështetur edhe kërkesa e parë, ku kërkonte përjashtimin e L.D. nga trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen e tij (“kërkesa e dytë”). Gjithashtu, kërkuesi theksoi se si rezultat i padisë së tij kundër L.D. (shih paragrafin 15 më sipër), ky i fundit nuk do të kishte paanshmëri në dëgjimin e çështjes së kërkuarit. Më 5 shkurt 2020, KPA-ja, e mbledhur si një trup tjetër gjykuese krahasuar me trupën e cila shqyrtoi meritat e procesit të rivlerësimit të kërkuarit, e rrëzoi kërkesën e dytë me të njëjtat arsye si ato të paraqitura në paragrafin e mëparshëm – më konkretisht, se KPA-ja nuk kishte juridiksionin të shqyrtonte kërkesën për sa kishte të bënte me zhvillimet që kishin ndodhur përpara emërimit të anëtarëve të KPA-së. Gjithashtu, ajo arriti në përfundimin se padia penale e kërkuarit kundër L.D. nuk ndikonte në paanshmërinë e tij për të dëgjuar çështjen.

37. Më 7 shkurt 2020, kërkuesi paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese ku kërkonte që gjykata ta shpallte jokushtetues vendimin e Parlamentit, sipas së cilit L.D. emërohej në KPA (shih paragrafin 14 më sipër), pasi L.D. nuk përmbushte kriteret përkatëse për përzgjedhjen e tij në detyrë.

38. Në vijim, në një seancë dëgjimore me dyer të hapura, më 11 shkurt 2020, përpara KPA-së, kërkuesi kërkoi që të ndërpriteshin procedurat e rivlerësimit ndaj tij deri në momentin kur Gjykata Kushtetuese të jepte një vendim për ankesën e tij dhe deri në momentin kur të përfundonin procedurat penale ndaj L.D. (të cilat në atë periudhë ishin në vijimësi). KPA-ja e refuzoi kërkesën.

39. Më 27 shkurt 2020, KPA-ja, pasi mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të palëve dhe pasi bëri një rivlerësim të ri të provave në dosjen e çështjes, e rrëzoi vendimin e KPK-së dhe e shkarkoi kërkuarin nga detyra me efekt të menjëhershëm. KPA-ja vlerësoi se, mbështetur në një “analizë financiare” të kryer prej saj, kërkuesi kishte bërë një deklaratë të pasaktë dhe të pamjaftueshme të pasurisë që i përkiste atij dhe personave të lidhur me të. Në vijim, KPA-ja konstatonte se për shkak të një marrëveshjeje tregtare të lidhur midis kërkuarit dhe një kompanie naftë, kishte pasur një konflikt interesi në pozicionin e tij si prokuror në detyrë, gjë që dëmtonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

40. Dy gjyqtarë dhanë një opinion dakordësues me vendimin e KPA-së, duke argumentuar se ata nuk binin dakord me peshën që i kishte dhënë shumica deklaratave të pasakta të kërkuarit, në lidhje me një makinë dhe një garazh që ai i kishte blerë gjatë karrierës së tij.

C. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

41. Si përgjigje ndaj kërkesës së ankuesit (shih paragrafin 37 më sipër), Gjykata Kushtetuese miratoi vendimin nr. 62 të datës 29 prill 2020, nëpërmjet së cilit e rrëzonte si të papranueshëm kundërshtimin e kërkuarit ndaj emërimit të L.D. në KPA.

42. Për sa kishte të bënte me faktin nëse ankesa mbështetej në paragrafin “e” të nenit 131 § 1 të Kushtetutës, i cili parashikonte juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të verifikuar përzgjedhjen dhe emërimin e zyrtarëve në organet kushtetuese (shih paragrafin 45 më poshtë), gjykata vlerësoi se individët nuk kishin pozitën për të nisur një shqyrtim të tillë kushtetues. Në përputhje me rrethanat, ajo arriti në përfundimin se kundërshtimi i ankuesit ndaj emërimit të një anëtarit të KPA-së nuk pajtohej *rationae personae* me Kushtetutën.

43. Për sa kishte të bënte me ankesën e kërkuarit në mbështetje të paragrafit “f” të nenit 131 § 1 të Kushtetutës (po aty) se emërimi i L.D. në KPA në shkelje të ligjit vendës shkelte të drejtën individuale të ankuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj” gjatë procedurave të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën, me arsyetimin e mëposhtëm:

“20. Në çështjen konkrete, Kolegji [i Gjykatës Kushtetuese] vëren se ankuesi pretendon të jetë



cenuar e drejta e tij për një gjykim të drejtë për shkak të një veprimi të ndërmarrë nga një autoritet publik përpara përfundimit të procedurave në KPA, dhe, për pasojë nuk ngre asnjë pretendim kundër rezultatit përfundimtar të procesit [të *vetting*-ut]. Ai ka kundërshtuar ... emërimin [e L.D. në KPA] dhe [ka kërkuar] pavlefshmërinë e pjeshme të vendimit të Parlamentit që caktonte L.D. si anëtar të KPA-së.

21. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë, duke përfshirë ankesat në lidhje me gjykatën e krijuar me ligj, garantohet gjatë një procesi ligjor ose gjyqësor në funksion të rezultatit përfundimtar, i cili sjell pasoja konkrete dhe të drejtpërdrejta për ankuesit si mbajtës i të drejtave kushtetuese procedurale dhe thelbësore. Kolegji vlerëson se edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar, në procesin gjyqësor të kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të garantohen të drejtat procedurale të subjekteve të rivlerësuar, në përputhje me kompetencat që përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligji.

23. Për më tepër, Kolegji vëren se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimit individual kushtetues të kërkuar, që lidhet me kryerjen e rivlerësimit kalimtar të tij, për shkak të detyrës së prokurorit, është i kufizuar nga juridiksioni që vetë Kushtetuta, në aneksin e saj, u ka dhënë organeve të rivlerësimit. Kështu, neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

24. Kolegji thekson se të drejtat procedurale kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit [...], duke përfshirë të drejtën për një “gjykatë të krijuar me ligj”, garantohen nga Kushtetuta, me anë të një procesi gjyqësor të kryer nga KPA-ja, dhe më pas, me anë të mundësisë për të ushtruar të drejtën ankimi në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Duke pasur parasysh pushtetin e KPA-së për të gjykuar apeli kundër vendimeve të KPK-së, gjykata vlerëson se ky proces [apeli] përfshin shqyrtimin e pajtueshmërisë së procedurave me Kushtetutën ...”

KUADRI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

I. LIGJI PËRKATËS VENDËS

A. Kushtetuta

44. Pjesët e neneve 127 dhe 128 të Kushtetutës, të ndryshuar në vitin 2016, të cilat kanë lidhje me çështjen konkrete, parashikojnë si më poshtë:

“Neni 127

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron, kur:

...

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

...

Neni 128

...

2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij, kur:

...

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”

45. Neni 131 i Kushtetutës, ndryshuar në vitin 2015 dhe 2016, parashikon si më poshtë:

“Gjykata Kushtetuese vendos, për

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”

46. Në mbështetje të nenit 179/b § 5 të Kushtetutës, KPA u krijua si njëri prej kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese për një periudhë të kufizuar prej nëntë vjetësh.

47. Në mbështetje me nenin C § 3 të aneksit të Kushtetutës, gjyqtarët e KPA-së kanë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

48. Neni F § 8 i aneksit të Kushtetutës parashikon se subjektet e rivlerësuar kanë të drejtën



të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

B. Ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – “Ligji i rivlerësimit”)

49. Sipas nenit 4(6), organet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative (ligji nr. 44/2015, i ndryshuar) ose në ligjin për gjykatat administrative (ligji nr. 49/2012, i ndryshuar), nëse e gjykojnë të përshtatshme, dhe nëse një procedurë e caktuar nuk parashikohet në Kushtetutë ose në ligjin e rivlerësimit.

50. Neni 6(1) (dh) i ligjit të rivlerësimit parashikon:

“Neni 6 – Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit

1. Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

...

c) [ai/ajo] të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesional, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme;

...

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit [për një pozicion në organet e rivlerësimit];”

C. Ligji për statusin e gjyqtarëve (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar)

51. Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili hyri në fuqi më 22 nëntor 2016, parashikon rregullat për statusin e magistratëve – që do të thotë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

52. Neni 28 parashikon kriteret që duhet të përmbushë një individ për t’u emëruar si magistrat; pika “dh” e këtij neni parashikon se një individ ka të drejtën të aplikojë për t’u pranuar në kursin e trajnimit fillestar për magistratët, nëse ai ose ajo nuk është shkarkuar nga detyra për arsye disiplinore dhe nuk ka qenë subjekt i ndonjë sanksioni disiplinor i cili është ende në fuqi.

53. Neni 66 i ligjit parashikon:

“Neni 66

Përzgjedhshmëria dhe papajtueshmëria

1. Statusi i magistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë, si vijon:

a) kur magistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij LIGJI;

b) kur vendimi i emërimit është i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike, si edhe konsiderohet se nuk ekziston.

...

4. Këshilli [i Lartë Gjyqësor] deklaron me vendim mbarimin e statusit të magistratit, jo më vonë se dy javë nga marrja e njoftimit për shkakun e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë.

5. Vendimi përcakton datën e mbarimit të statusit të magistratit, sipas parashikimit të pikës 1 ose 2 të këtij neni.

6. Çdo veprim i kryer nga magistrati pas kësaj date është i pavlefshëm dhe konsiderohet që nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston.”

54. Neni 150(3) përcakton se masa disiplinore e largimit nga detyra ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri i masave disiplinore, i cili mbahet nga autoritetet përgjegjëse.

D. Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor i vitit 2008 (ligji nr. 9877/2008 i datës 18 shkurt 2008 për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Gjyqësor, i ndryshuar – në fuqi deri më 22 nëntor 2016)

55. Nenet përkatëse të ligjit për pushtetin gjyqësor 2008 parashikojnë, si vijon:

“Neni 32

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet e disiplinës së gjyqtarit ndahen në:

a) shumë të rënda;

b) të rënda;

c) të lehta.

...

Neni 33

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

2. Masat disiplinore janë:

a) vërejtje;



b) vërejtje me paralajmërim;

c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët;

ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij;

d) shkarkim nga detyra.

3. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 2 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij neni.

4. Për shkeljet e rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 3 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni.

5. Për shkeljet e lehta, të parashikuara në nenin 32 pika 4 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni.

6. Për efekt të procedimit disiplinor, masat disiplinore të rënda shlyhen brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, ndërsa masat disiplinore të lehta shlyhen brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.”

E. Parashikime të tjera të lidhura me çështjen

56. Neni 494 § (ë) i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë në rastin kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstaton një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, të cilat janë ratifikuar nga Shqipëria.

57. Paragrafi 3 i nenit 71/c të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 2000, i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016) parashikon se pas dhënies së një vendimi nga një gjykatë ndërkombëtare ku vlerësohet se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka cenuar të drejtat dhe liritë bazë të një individi, pala e interesuar mund të kërkojë rihapjen e procedurave konkrete në Gjykatën Kushtetuese. Sipas paragrafit 5(b) të të njëjtit nen, një kërkesë e tillë nuk lejohet, nëse gjykata ndërkombëtare ka dhënë një dëmshpërblim pa e shoqëruar me rihapje të procesit.

58. Parashikimet e tjera të ligjit dhe të praktikës vendëse, në lidhje me çështjen konkrete

janë parashikuar në vendimin *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 93–209.

II. PRAKTIKA VENDËSE

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese

59. Me anë të vendimit nr. 59, të datës 23 dhjetor 2014, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën e paraqitur nga një numër deputetësh, të cilët, ndër të tjera, kishin kërkuar që gjykata t'i shpallte jokushtetuese tri vendimet e Parlamentit që shkarkonin nga detyra drejtuesin – dhe në vijim emëronin një drejtor të ri – e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktet e Interesit (një organ administrativ i pavarur). Ndër të tjera, gjykata konstatoi se më shumë se sa akte rregullatorë, aktet e kundërshtuara kishin qenë vendime individuale, në lidhje me shkarkimin e një zyrtari publik; për këtë arsye, çdo vlerësim i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën ishte nën juridiksionin e gjykatave administrative të zakonshme, përpara se cilave procedurat tashmë ishin ndërmarrë nga pala e interesuar.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR NJË GJYKATË TË KRIJUAR ME LIGJ PËR PRANINË E L.D. NË TRUPËN E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

60. Kërkuesi u ankua në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës se të drejtat dhe detyrimet e tij civile nuk ishin përcaktuar nga një “gjykatë e krijuar me ligj”, pasi L.D. (i cili ishte ulur në trupën e KPA-së që gjykoi çështjen e kërkuarit) ishte caktuar në detyrë në shkelje të ligjit vendës.

61. Pjesa përkatëse e nenit 6§1 të Konventës parashikon, si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

62. Qeveria parashitroi, se sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 59 më sipër), kushtetutshmëria e akteve (jo rregullatorë) individual – duke përfshirë vendimin e Parlamentit



për emërimin e anëtarit konkret të KPA-së në çështjen e ankuesit – duhej të ishte kundërshtuar në gjykatat administrative të zakonshme në vend që të kundërshtohej në Gjykatën Kushtetuese. Duke qenë se ankuesi nuk i kishte ndërmarrë këto procedura, sipas këndvështrimit të Qeverisë, ai nuk kishte shteruar mjete e disponueshme vendëse.

63. Gjithashtu, Qeveria deklaronte se ankesa e kërkuarit ishte haptazi e pambështetur.

64. Ankuesi parashittoi se ai i kishte shteruar të gjitha mjetet e disponueshme vendëse duke ngritur më herët në mënyrë të veçantë çështjen e emërimit të paligjshëm të gjyqtarit L.D., respektivisht në KPA dhe në Gjykatën Kushtetuese, ku të dyja kishin refuzuar të shqyrtonin pretendimet e tij. Ai argumentoi se gjykatat administrative nuk kishin juridiksion për të vendosur nëse një gjyqtar ishte caktuar në KPA, në përputhje me ligjin, dhe theksoi se praktika gjyqësore kushtetuese, e cituar nga Qeveria konkrete, kishte lidhje me një kundërshtim ndaj emërimit të një zyrtari të një organi administrativ, dhe për këtë arsye nuk kishte lidhje me çështjen konkrete.

2. Vlerësimi i Gjykatës

65. Paraprakisht, palët nuk kundërshtuan, dhe Gjykata dakordësohet se neni 6 § 1 i Konventës zbatohet në këtë aspekt civil të procedurave për rivlerësimin e ankuesit (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, § 9 shkurt 2021).

66. Për t'u kthyer te shterimi i mjeteve vendëse, Gjykata përsërit se rregullisht referuar në nenin 35 § 1 të Konventës i detyron personat që kërkojnë të paraqesin një çështje kundër Shtetit përpara një organi gjyqësor ndërkombëtar të përdorin fillimisht mjetet e garantuara nga sistemi ligjor kombëtar, duke i përjashtuar Shtetet, në këtë mënyrë, nga detyrimi që të përgjigjen përpara një organi ndërkombëtar për aktet e tyre përpara se të kenë përdorur mundësinë për t'i zgjidhur çështjet në mënyrën e duhur në sistemet e tyre ligjore. Për të respektuar rregullin, një ankuesi i duhet ofruar rekursi i zakonshëm ndaj mjeteve që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të përballuar zgjidhjen për shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve konkrete duhet të jetë mjaftueshme e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pasi në të kundërt atyre do t'u mungojë aksesueshmëria dhe efikasiteti i nevojshëm (shih *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë*

(kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17165/11 dhe 29 të tjerë, § 70, 25 mars 2014).

67. Është përgjegjësia e Qeverisë që pretendon mosshkrimin për t'i provuar Gjykatës së mjeti ishte efektiv, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në periudhën përkatëse. Pasi një barrë e tillë të jetë provuar, i mbetet ankuesit të provojë se mjeti i garantuar nga Qeveria faktikisht u shterua ose se për disa arsye të caktuara ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, apo se ekzistonin rrethana të veçanta që e çlironin atë nga kjo kërkesë (po aty, § 77).

68. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Qeveria nuk iu përgjigj pretendimit specifik të ankuesit se nuk i takonte një gjykatë administrative të shkallës së parë që të vendoste për ligjshmërinë e emërimit të një gjyqtari në KPA, një prej gjykatave më të larta në vend. Gjykata ndan dyshimet e ankuesit për këtë aspekt.

69. Sido që të jetë, Gjykata bie dakord me argumentin e ankuesit se praktika gjyqësore tek e cila u mbështet Qeveria nuk duket të jetë e përshtatshme për sa i përkiste shkarkimit nga detyra dhe emërimit nga Parlamenti të një zyrtari të një organi administrativ, ndërsa ankesa e kërkuarit kishte të bënte me një gjyqtar të KPA-së, i cili është një organ gjyqësor dhe kushtetues (shih paragrafin 59 më sipër), gjyqtarët e të cilit kanë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 47 më sipër). Për më tepër, Qeveria nuk citonte ndonjë vendim të dhënë nga një gjykatë administrative e shkallës së parë që të kishte shërbyer si një mjet efektiv në situatat e krahasueshme me atë të ankuesit.

70. Më i rëndësishëm është fakti se Gjykata vëren që KPA dhe Gjykata Kushtetuese – përpara së cilave ankuesi paraqiti procedurat për këtë çështje, dhe të cilat kishin, në këtë mënyrë, mundësinë të zbatonin praktikën gjyqësore të cituar nga Qeveria, e cila pretendohet të ishte e mirëpërcaktuar – nuk iu referuan asaj jurisprudence apo gjykatës administrative të shkallës së parë si një mjet që mund të përdorej nga ankuesi. Qeveria nuk identifikoi as ndonjë çështje për mosshkrim, në lidhje me veprimet e ankuesit.

71. Përkundrazi, një nga arsyet referuar nga Gjykata Kushtetuese në kundërshtimin e ankesës së kërkuarit ishte se e drejta e kërkuarit për një “gjykatë të krijuar me ligj” garantohej gjatë procesit të rivlerësimit të kryer përpara dhe nga KPA (shih



§§ 21 dhe 24 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të paraqitur në paragrafin 43 më sipër), juridiksioni ekskluziv i së cilës e hoqi çështjen nga juridiksioni i zakonshëm i Gjykatës Kushtetuese. Ky përfundim i Gjykatës Kushtetuese vë në dyshim qëndrimin e Qeverisë se ankesa e kërkuarit në lidhje me të drejtën e tij për një “gjykatë të krijuar me ligj” ishte nën juridiksionin e gjykatave administrative.

72. Në lidhje me rrethanat, Gjykata nuk mundet të ndjekë pretendimin e Qeverisë se gjykata administrative e shkallës së parë ishte një mjet efektiv për sa i përkiste kundërshtimit të kërkuarit për emërimin e L.D. në KPA (shih paragrafin 67 më sipër).

73. Për sa më sipër, pretendimi i Qeverisë për mosshfrytëzim rrëzohet.

74. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është as haptazi e pambështetur dhe as e papranueshme, sipas arsyeve të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuari

75. Kërkuari parashtroi se trupa e KPA-së e cila kishte shqyrtuar çështjen e tij nuk përbënte një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës, pasi njëri prej gjyqtarëve, më konkretisht L.D., nuk kishte përmbushur kushtet statutorë të përzgjedhshmërisë për t’u emëruar në KPA si gjyqtar.

76. Veçanërisht, ankuesi parashtroi se neni 6(1)(dh) i ligjit për rivlerësimin parashikonte se kandidatët, të cilët ishin shkarkuar më herët nga detyra nuk mund të emëroheshin si gjyqtarë të KPA-së; për këtë arsye, L.D. i cili ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë në vitin 1997 nuk e kishte përmbushur atë kusht dhe për pasojë, ishte emëruar në shkelje të ligjit.

77. Për më tepër, ankuesi parashtroi se L.D. nuk kishte përmbushur një numër kriteresh të tjera për përzgjedhshmërinë, në lidhje me kohëzgjatjen e eksperiencës së tij profesionale, notën mesatare që kishte arritur gjatë studimeve të tij në drejtësi, gradat akademike dhe njohuritë në gjuhën angleze.

78. Për sa më sipër, ankuesi argumentonte se Avokati i Popullit dhe Parlamenti duhet t’i kishin kontrolluar kandidatët për KPA me më shumë kujdes dhe duhet të ishin siguruar se të gjithë anëtarët e KPA-së kishin një nivel të lartë të integritetit moral dhe profesional, për shkak të

pushtetit të tyre për të vendosur në lidhje me ndërprerjen e karrierave të magistratëve të cilët kishin shërbyer për shumë vite në sistemin e drejtësisë. Sipas opinionit të ankuesit, kjo ishte e vetmja mënyrë për të garantuar se procesi i rivlerësimit ishte i ligjshëm dhe i besueshëm në sytë e publikut dhe të magistratëve.

b) Qeveria

79. Qeveria kundërshtoi pohimin e ankuesit se kishte pasur një shkelje të kërkesës për një “gjykatë të krijuar me ligj” në përputhje me nenin 6 § 1 të Konventës.

80. Qeveri argumentoi se duke qenë se L.D. kishte fshehur faktin se ai nuk kishte përmbushur kriteret e përzgjedhshmërisë të parashikuara në nenin 6(1) (dh) të ligjit për rivlerësimin, Avokati i Popullit dhe ONM nuk kishin pasur arsye të kryenin një hetim të detajuar në historikun e karrierës së tij. Në të njëjtën mënyrë, L.D. kishte fshehur shkarkimin e tij të mëparshëm nga detyra kur ishte pyetur specifikisht nga komisioni parlamentar i posaçëm nëse ishte shkarkuar ndonjëherë nga ndonjë detyrë; prandaj, Parlamenti nuk mund të kritikohej për faktin se e kishte emëruar L.D. në KPA. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, fakti ndalues për emërimin e L.D. në KPA ishte bërë i ditur vetëm në një fazë të mëvonshme dhe Parlamenti nuk kishte vepruar në mënyrë arbitrare apo të qëllimshme në emërimin e L.D. në KPA.

81. Në vijim Qeveria argumentoi se duhej bërë dallimi midis çështjes konkrete dhe çështjes *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* ([DHM], nr. 26374/18, 1 dhjetor 2020), pasi nuk kishte pasur ndërhyrje politike në emërimin e L.D. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se, në përgjithësi, ishin respektuar rregullat për emërimin e L.D. në KPA, ndërsa shkelja e pretenduar nga ankuesi nuk kishte qenë shumë e rëndë; për këtë arsye, nuk kishte pasur shkelje të ndonjë rregulli themelor, në lidhje me procedurën për emërimin e gjyqtarëve.

82. Për sa i përket aspektit, nëse pretendimet e ankuesit ishin adresuar nga autoritetet vendëse, Qeveria iu referua kërkesave të paraqitura nga ankuesi në KPA (shih paragrafët 35 dhe 36 më sipër), ankesave të tij kushtetuese dhe penale dhe procedurave disiplinore kundër L.D., duke parashtruar se ishte e qartë se autoritetet vendëse i kishin adresuar rregullisht pretendimet e ankuesit.



2. Vlerësimi i Gjykatës

3.

a) Në lidhje me ndikimin e shkarkimit të mëparshëm nga detyra të L.D. në emërimin e tij të radhës në KPA*i. Parimet e përgjithshme*

83. Në vendimin e saj në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* (cituar më sipër, § 218 e në vijim), Dhoma e Madhe e Gjykatës sqaroi fushën e veprimit të, dhe kuptimin që i jepej, konceptit një “gjykatë e krijuar me ligj”. Gjykata analizoi komponentët individual të atij koncepti dhe gjykoi se si duhej të interpretoheshin në mënyrë që të reflektohej qëllimi i tij, dhe domosdoshmërisht, të garantohej se mbrojtja që ofronte ishte me të vërtetë efektive.

84. Në lidhje me nocionin një “gjykatë”, përveç detyrimeve që lindnin nga praktika gjyqësore e Gjykatës, Gjykata theksoi rëndësinë e padiskutueshme të një procesi rigoroz për emërimin e gjyqtarëve për t’u garantuar se në postet gjyqësore do të emëroheshin kandidatët më të kualifikuar – si në aspektin e kompetencës teknike edhe të integritetit moral. Gjykata nënvizoi se sa më lartë në hierarki të pozicionohej një gjykatë, aq më kërkuese duhej të ishin kriteret e aplikueshme për përzgjedhjen. Në opinionin e Gjykatës, një përzgjedhje e tillë e mbështetur në merita nuk garanton vetëm kapacitetin teknik të një organi gjyqësor në dhënien e drejtësisë si një “gjykatë”, por është e rëndësishme edhe për të siguruar besimin e publikut në gjyqësor (po aty, § 222).

85. Në lidhje me termin “krijuar”, Gjykata konstatoi se procesi për emërimin e gjyqtarëve në mënyrë të domosdoshme përfshinte një element të rëndësishëm të konceptit “krijuar me ligj”, duke pasur në konsideratë rëndësinë e saj themelore për funksionimin e duhur dhe legjitimitetin e gjyqësorit në një shtet demokratik të udhëhequr nga shteti i së drejtës. Në gjykimin e Gjykatës, shkeljet e ligjit që rregullon procesin e emërimeve në gjyqësor mund të sillnin pjesëmarrjen “e parregullt” të gjyqtarit konkret në shqyrtimin e një çështje (po aty, §§ 226–227).

86. Në lidhje me shprehjen “me ligj”, Gjykata sqaroi se edhe komponenti i tretë nënkuptonte një “gjykatë e krijuar në përputhje me ligjin”. Ajo vlerësoi se ligji respektiv vendës për emërimet në gjyqësor duhej të shprehej në terma sa më të qartë të ishte e mundur, në mënyrë që të mos lejoheshin

ndërhyrje arbitrare në procesin e emërimit (po aty, §§ 229–230).

87. Në vijim Gjykata theksoi se edhe pse e drejta për një “gjykatë të krijuar me ligj” ishte një e drejtë e pavarur, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, një ndërlidhje shumë e afërt ishte formuluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës midis asaj të drejte specifike dhe garancive për “pavarësi” dhe “paanshmëri”. Kërkesat institucionale të nenit 6 § 1 shprehnin qëllimin e zakonshëm për ruajtjen e parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjen e pushteteve (po aty, §§ 231–233).

88. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata theksoi se parimi i shtetit të së drejtës përfshin një numër parimesh të tjera po aq të rëndësishme dhe mundësisht kundërbalacuese (po aty, §§ 237–240). Këto parime përfshijnë veçanërisht sigurinë ligjore dhe respektin për forcën e *res judicata*, si edhe parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre; shmangia nga këto parime mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të mirëpërcaktuara. U takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështje” (po aty, § 240).

89. Për të vlerësuar nëse parregullsitë në një procedurë të caktuar për emërimet në gjyqësor ishin aq serioze sa të passillnin shkeljen e së drejtës për një gjykatë të themeluar me ligj, dhe nëse balanca midis parimeve detyruese është prishur nga autoritetet shtetërore, Gjykata përgatiti një test matës të përbërë nga tri kriteret, të përzgjedhura në mënyrë kumulative (po aty, § 243).

90. Fillimisht, në parim, duhet të ekzistojë një shkelje e dukshme e ligjit vendës, në kuptimin që shkelja duhet të jetë e identifikueshme në mënyrë objektive dhe të vërtetë. Në përcaktimin e këtij aspekti, Gjykata do të mbështetet në interpretimin e gjykatave vendëse, për faktin nëse ka pasur një shkelje të ligjit vendës, në rast se shkelja nuk është “flagrante” – që do të thotë, nëse konstatimet e gjykatave vendëse nuk mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Megjithatë, mungesa e një shkeljeje të tillë nuk përjashton mundësinë e shkeljes së të drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj, duke qenë se një procedurë e cila duket se është në përputhje me rregullat vendëse,



gjithsesi mund të sjellë rezultate, të cilat nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e asaj të drejte. Në një rast të tillë, Gjykata, sipas rastit, duhet të bëjë shqyrtimin e saj sipas kriterit të dytë dhe të tretë të testit, paraqitur në vijim, për të përcaktuar nëse rezultatet e zbatimit të rregullave konkret vendës kanë qenë në përputhje me kërkesat specifike të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj” sipas kuptimit në Konventë (po aty, §§ 244–245).

91. Së dyti, shkelja konkrete duhet të vlerësohet sipas objektit dhe qëllimit të kërkesës për një “gjykatë të krijuar me ligj” – më konkretisht, të garantohet se gjyqësori realizon detyrat e tij i pavarur nga ndërhyrje të parregullta dhe në këtë mënyrë ruan shtetin e së drejtës dhe ndarjen e pushteteve. Sipas rrethanave, shkeljet e një natyre tërësisht teknike, të cilat nuk kanë ndikim në legjitimitetin e procesit të emërimeve duhet të konsiderohen se janë nën pragun konkret. Nga ana tjetër, shkeljet të cilat cenojnë rregullat më themelore në procedurën e emërimeve (të tillë si kriteret e përzgjedhshmërisë) ose shkeljet që mund të dëmtojnë qëllimin dhe ndikimin e kërkesës “të krijuar me ligj” (sipas interpretimit të Gjykatës) duhet të konsiderohen se e shkelin atë kërkesë (po aty, § 246).

92. Së treti, shqyrtimi i realizuar nga gjykatat vendëse, nëse ka ndonjë të tillë, për pasojat ligjore – për sa u përket të drejtave të një individi sipas Konventës – e një shkeljeje të një rregulli të brendshëm, në lidhje me emërimet gjyqësore luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin nëse një shkelje e tillë ka cenuar të drejtën e aksesit në një “gjykatë të krijuar me ligj”, dhe në këtë mënyrë, bëhet pjesë e vet testimit. Një vlerësim nga gjykatat vendëse të efekteve ligjore për një shkelje të tillë duhet të kryhet në mbështetje të praktikës gjyqësore përkatëse të Konventës dhe parimeve që burojnë prej saj (po aty, §§ 248 dhe 250).

93. Gjykata e ka zbatuar testimin e mësipërm në një sërë çështjesh të kohëve të fundit që kanë lidhje me kërkesën në nenin 6 §1 të Konventës se një gjykatë duhet të krijohet me ligj (shih, çështjet më të fundit, *Advance Pharma sp. Z o.o kundër Polonisë*, nr. 1469/20, § 349, 3 shkurt 2022; *Dolińska-Ficek dhe Ozimek kundër Polonisë*, nr. 49868/19 dhe 57511/19, § 353, 8 nëntor 2021; *Reczkowicz kundër Polonisë*, nr. 43447/19, § 280, 22

korrik 2021; dhe *Xero Flor w Polsce sp. z o.o. kundër Polonisë*, nr. 4907/18, §289, 7 maj 2021).

ii. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

a) Nëse pati një shkelje të qartë të ligjit vendës

94. Për të përcaktuar nëse u cenua ligji vendës si rezultat i emërimit të gjyqtarit L.D. në KPA, Gjykata duhet të identifikojë pozicionin e autoriteteve vendëse, në lidhje me këtë aspekt. Kështu, Gjykata vëren, se KPA-ja dhe Gjykata Kushtetuese nuk e shqyrtuan këtë aspekt (shih paragrafët 35, 36 dhe 41 më sipër), ndërsa procedurat disiplinore ndaj L.D. u ndërmorën me arsyetimin se ai ishte dënuar për një veprë penale pas emërimit të tij në detyrë (shih paragrafin 16 më sipër); për këtë arsye, procedurat nuk përcaktuan aspektin specifik nëse emërimi fillestar i L.D. ishte bërë në përputhje me ligjin. Për sa i përket procesit penal kundër L.D., ai kishte të bënte me aspektin nëse ai kishte kryer falsifikim në aplikimin e tij për pozicionin e gjyqtarit në KPA; përsëri, kjo problematikë është e ndryshme nga problematika që ka të bëjë me faktin nëse emërimi i tij ishte i ligjshëm. Në shqyrtimin e elementit *mens rea* të akuzës për falsifikim kundër L.D., gjykatat penale vendëse bënë një sërë konstatimesh për faktin nëse L.D. kishte përmbushur kërkesat e ligjit vendës, në lidhje me aplikimin e tij për pozicionin e gjyqtarit në KPA. Megjithatë, nuk rezulton se gjykatat e zakonshme, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, kishin pushtetin të merrnin një vendim për ligshmërinë e emërimit të L.D., i cili si gjyqtar i KPA-së, kishte statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Duke iu referuar rrethanave, Gjykata vlerëson, se aspekti, nëse kishte pasur një shkelje të qartë të ligjit vendës në emërimin e L.D. në KPA, nuk kishte marrë përgjigje nga gjykatat vendëse. Sidoqoftë, Gjykata mund të marrë në konsideratë konstatimet kontekstuale të gjykatave vendëse për këtë aspekt.

95. Në vlerësimin e problematikës nëse ka pasur në të vërtetë një shkelje të qartë të ligjit vendës, Gjykata do të mbajë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, të cilat nuk u kundërshtuan nga palët. Së pari, neni 6(1) (dh) i ligjit për rivlerësimin parashikonte, se një kandidat i cili ka qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në kohën e aplikimit të tij për pozicionin e gjyqtarit në KPA, nuk mund të emërohej në atë pozicion (shih paragrafin 50 më sipër). Sipas rrethanave, emërimi pranë KPA-së i një kandidati i cili nuk përmbushte atë kusht ishte në kundërshtim me ligjin vendës. Së



dyti, L.D. kishte qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në vitin 1997, për shkelje të ligjit dhe për paaftësi (shih paragrafin 8 më sipër).

96. Një tjetër aspekt i pakundërshtuar midis ankuesit dhe Qeverisë ishte edhe fakti se masa disiplinore kundër L.D. vijonte të ishte në fuqi – që do të thotë se ajo nuk ishte hequr nga të dhënat e tij. Edhe pse Gjykata e Lartë e kishte marrë në konsideratë faktin se masa disiplinore kundër L.D. nuk ishte hequr nga të dhënat e tij, Gjykata thekson se ato konstatime ishin kufizuar brenda qëllimit për të vlerësuar përgjegjësinë penale të L.D. në lidhje me deklaratat e bëra në aplikimin e tij për pozicionin në KPA, dhe jo në ligjshmërinë e emërimit të tij nga Parlamenti, si e tillë. Kjo çështje e fundit do të kërkonte interpretimin e rregullave përkatës të parashikuar në ligjin shqiptar për heqjen nga të dhënat e gjyqtarëve të shkeljeve disiplinore të kryera prej tyre, duke u lexuar së bashku me nenin 6(1) (dh) të ligjit të rivlerësimit. gjithashtu, neni 6(1) (c) i ligjit të rivlerësimit (shih paragrafin 50 më sipër), u jepte të drejtën kandidatëve për pozicionin e gjyqtarit në një nga organet e *vetting*-ut, në rast se gjatë karrierës së tyre ata kishin marrë vlerësime pozitive për aftësitë dhe etikën e tyre profesionale dhe për integritetin e tyre moral, gjë që vështirë se mund të jetë e mundur, duke pasur parasysh shkarkimin e mëparshëm nga detyra për “shkelje të ligjit dhe paaftësi”.

97. E teksa nuk i takon Gjykatës të japë një interpretim përfundimtar të ligjit vendës, veçanërisht në mungesë të deklarimeve të qarta dhe autoritare të gjykatave vendëse, është e qartë se shkarkimi i L.D. nga detyra në vitin 1997 si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë ka ngritur pikëpyetje të rëndësishme për sa i përket ligjshmërisë së emërimit të tij nga Parlamenti në pozicionin e gjyqtarit të KPA-së, gjë e cila u kundërshtua në vijim nga ankuesi gjatë procedurave vendëse. Për këtë arsye, Gjykata do të procedojë mbi bazën se pretendimi i ankuesit për këtë aspekt ishte për t’u diskutuar dhe mjaftueshëm serioz sa për të krijuar detyrimin për gjykatat vendëse që ta merrnin në konsideratë këtë problem.

98. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuar ngriti një pretendim serioz dhe që duhej të shqyrtohej për një shkelje të qartë të ligjit vendës, në lidhje me emërimin e L.D. në KPA.

b) Nëse shkelja e ligjit vendës kishte lidhje me një rregull themelor për procedurën për emërimin e gjyqtarëve

99. Në rastin kur përcaktohet nëse një defekt i caktuar në procesin e emërimeve në gjyqësor ka qenë aq i rëndë sa të shkaktojë një shkelje të së drejtës për “një gjykatë të krijuar me ligj”, i duhet kushtuar vëmendje, midis të tjerash, qëllimit të ligjit që duket se është shkelur – që do të thotë, nëse kërkonte të parandalohet një ndërhyrje e parregullt nga ana e ekzekutivit apo legjislativit në gjyqësor, dhe nëse shkelja konkrete dëmtonte vetë esencën e së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj” (shih *Guðmundur Andri Astráðsson*, cituar më sipër, §§ 226 dhe 225). Në lidhje me këtë, Gjykata ka nënvizuar tashmë se kërkesat për përzgjedhshmërinë në emërimin e gjyqtarëve konsiderohen si rregulla themelore, shkelja e të cilëve cenon qëllimin dhe ndikimin e kërkesës të “krijuar me ligj” (shih, po aty, § 246).

100. Sipas rrethanave, Gjykata do ta përcaktojë këtë pikë sipas qëllimit të rregullit që pretendohet të jetë shkelur – me konkretisht neni 6(1)(dh) i ligjit të rivlerësimit. Argumenti i Qeverisë, se janë respektuar rregullat e tjerë që zbatohen për emërimin e gjyqtarëve të KPA-së, ka një peshë të kufizuar në këtë vlerësim.

101. Gjykata vëren se, me përjashtim të argumentit të sipërpërmendur se janë zbatuar rregullat e tjera për emërimin e gjyqtarit L.D. në KPA, Qeveria nuk parashtroi ndonjë koment në lidhje me qëllimin e seksionit 6 (1)(dh) të ligjit të rivlerësimit; dhe nuk paraqiti as ndonjë arsye se përse ai rregull duhet të konsiderohet si një rregull teknik, shkelja e të cilit nuk do të ishte e ndonjë serioziteti të konsiderueshëm.

102. Nga ana tjetër, ankuesi parashtroi – dhe Gjykata ra dakord – se rregulli konkret synonte të ruante legjitimitetin dhe besimin e publikut te procesi i rivlerësimit. Edhe Gjykata prirte të jetë dakord me gjykatat vendëse, të cilat – për aq sa ato e trajtuan këtë çështje sipas kontekstit të procesit penal ndaj L.D. – bënë deklaratat të ngjashme në lidhje me rëndësinë e kërkesës për përzgjedhshmërinë të parashikuar në nenin 6(1)(dh) të ligjit të rivlerësimit (shih paragrafët 25 dhe 29 më sipër). Është e qartë se emërimi i një personi i cili nuk përmbush kriteret statutorë për një post të caktuar në gjyqësor mund të dëmtojë legjitimitetin e funksionit gjyqësor në fjalë. Sipas Gjykatës, rëndësia e kriterëve statutorë të



përzgjedhshmërisë për gjyqtarët është e qartë edhe në ligjin për gjyqtarët dhe prokurorët, i cili parashikon se mosrespektimi i kriterëve të përzgjedhshmërisë çon në ndërprerjen e mandatit të magjistratit në datën e vendimit, i cili e njeh një mosrespektim të tillë dhe pavarësisht periudhës që prej emërimit të parë (shih paragrafin 53 më sipër).

103. Në vijim, Gjykata vlerëson se për sa ka të bëjë me procedurat e rivlerësimit, KPA-ja është gjykata më e lartë në vend. Sipas rrethanave, emërimi në KPA i një kandidati, i cili më herët është shkarkuar nga detyra për një shkelje të ligjit dhe për paafësi (shih paragrafët 9 dhe 51 më sipër) vështirë se mund të pajtohet me kërkesën, që sa më i lartë të jetë niveli i një gjykate në hierarkinë e gjyqësorit, më kërkuese duhet të jenë kriteret e zbatueshme të përzgjedhjes (shih paragrafin 84 më sipër).

104. Edhe pse Qeveria nuk e kundërshtoi konstatimin se L.D. ishte emëruar në kundërshtim me nenin 6(1)(dh) të ligjit të rivlerësimit, ajo argumentoi se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuarit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, pasi L.D. nuk kishte treguar për masën disiplinore ndaj tij dhe autoritetet nuk kishin pasur dijeni për një gjë të tillë. Në vijim, Qeveria shprehej se në ndryshim nga rrethanat në çështjen *Guðmundur Andri Astráðsson*, në çështjen konkrete autoritetet vendëse nuk kishin ndërhyrë në procedurën e emërimit të L.D. në mënyrë të tillë që do të vinte në pikëpyetje pavarësinë e tij. Si pasojë, Gjykata do t'i adresojë këto argumente me radhë.

105. Në lidhje me argumentin e Qeverisë, se padijenja e autoriteteve për shkarkimin e L.D. nga detyra e tij si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Tiranë në vitin 1997 duhet të konsiderohet se përjashton mundësinë që autoritetet të kenë shkelur të drejtën e ankuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, Gjykata vlerëson se Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të tillë që të sigurojnë pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 6 § 1 (shih, *mutatis mutandis*, *Krastanov kundër Bullgarisë*, nr. 50222/99, § 74, 30 shtator 2004). Për këtë arsye, u takonte autoriteteve vendëse të përdornin të gjitha mjetet që kishin në dispozicion për të garantuar se gjyqtarët e KPA-së përmbushnin kërkesat statutores për pozicionin e tyre. Në lidhje me këtë, Gjykata bie dakord me pohimet e gjykatave vendëse se autoritetet përkatëse kishin detyrimin të verifikonin,

se aplikimi i L.D. për pozicionin e gjyqtarit në KPA respektonte kërkesat statutores për pozicionin e tij (shih paragrafët 26 dhe 28 më sipër).

106. Gjithashtu, Qeveria nuk iu referua ndonjë vështirësie për të verifikuar nëse L.D. kishte qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në të shkuarën. Nga ana tjetër, ai informacion ishte në të dhënat zyrtare dhe ishte cituar jo më vonë se sa në vitin 2016 në skualifikimin e L.D. nga pozicioni i gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë (shih paragrafin 9 më sipër). Gjithashtu, një anëtar i komisionit të posaçëm parlamentar i drejtoi L.D. një pyetje specifike të lidhur me largimin e tij të mëhershëm nga gjyqësori (shih paragrafin 13 më sipër).

107. Në lidhje me argumentin se pavarësia e L.D. nuk vihej në pikëpyetje nga autoritetet vendëse, Gjykata vlerëson se kërkesat që një gjykatë të jetë e “krijuar me ligj” dhe “e pavarur” përbëjnë të drejta të pavarura. Fakti se në disa raste ato shqyrtohen të lidhura me njëra-tjetrën, për shkak të lidhjes së tyre të ngushtë, nuk do të thotë se pajtueshmëria e mundshme me rregullat për kërkesën për “pavarësi”, nuk përjashton një shkelje të kërkesës që një gjykatë të jetë e “krijuar me ligj” (shih paragrafin 87 më sipër).

108. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se aspekti i përshtatshmërisë së gjyqtarit L.D. në detyrë kishte të bënte me një rregull themelor në lidhje me emërimin e gjyqtarëve të KPA-së.

c) Nëse pretendimet në lidhje me të drejtën për një “gjykatë të krijuar me ligj” u shqyrtuan dhe korrigjuan në mënyrë efektive nga gjykatat vendëse

109. Qeveria parashtroi, se, ndryshe nga rasti i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të zakonshme, nuk ka asnjë parashikim specifik në ligjin shqiptar që parashikon një ndërprerje të parakohshme të mandatit të një gjyqtari të KPA-së për arsyen se ai/ajo nuk kishte përmbushur kushtet e përzgjedhshmërisë. Në të njëjtën kohë, Qeveria iu referua efektit të kombinuar të procedurave në KPA, Gjykatën Kushtetuese dhe gjykatave penale, me argumentin se autoritetet vendëse i kishin shqyrtuar pretendimet e kërkuarit në lidhje me aspektin që KPA nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj” dhe i kishin korrigjuar ankesat e tij.

110. Në kërkesën e paraqitur prej tij më 17 janar 2020 (shih paragrafin 35 më sipër), teksa çështja e tij e rivlerësimit ishte në vijimësi në KPA, ankuesi paraqiti informacionet përkatëse faktike dhe ligjore



që mbështesnin pretendimin e tij të argumentueshëm se L.D. nuk ishte i përshtatshëm për pozicionin gjyqësor për shkakun se ai nuk kishte përmbushur kriteret e përzgjedhshmërisë në momentin e emërimit të tij (shih paragrafin 35). Pavarësisht kësaj, Gjykata tashmë ka konstatuar (shih paragrafin 94 më sipër) se asnjë autoritet vendës nuk ka shqyrtuar – dhe jo më të këtë korrigjuar – aspektin nëse L.D. ishte emëruar në KPA në përputhje me ligjin vendës. Autoritetet vendëse, veçanërisht, nuk mbajtën një pozicion të qartë për aspektin nëse L.D. do t'i ndërpritej mandati (dhe nëse po, nga cili autoritet), apo nëse ai mund të përjashtohej nga shqyrtimi i çështjes së kërkuarit për shkakun se ai nuk kishte respektuar kriteret përkatëse të përzgjedhshmërisë.

111. Në lidhje me këtë aspekt, vendimet kushtetuese dhe disiplinore nuk mund të korrigjonin ankesën e kërkuarit, sepse procedurat përfunduan pasi kërkuari ishte shkarkuar me anë të një vendimi të formës së prerë dhe të paankimueshëm nga KPA-ja.

112. I vetmi vendim që u shpall përpara shkarkimit të ankuesit ishte vendimi i KPA-së, e cila në datën 5 shkurt 2020 nuk pranoi të shqyrtonte kërkesat e ankuesit për përjashtimin e L.D. nga paneli i cili shqyrtonte çështjen e tij, me arsyetimin se i mungonte juridiksioni që të trajtonte pyetjet në lidhje me emërimin e tij në atë pozicion (shih paragrafin 36 më sipër). Qasja e KPA-së rezulton të jetë kontradiktore me vendimin e mëposhëm të Gjykatës Kushtetuese, duke nënvizuar se i takonte KPA-së, si një kolegji i veçantë i Gjykatës Kushtetuese, të garantonte respektimin e së drejtës së ankuesit për një gjykatë të krijuar me ligj. Së fundmi, në vendimin e tij për shkarkimin e L.D. nga detyra. Komisioni Disiplinor i KPA-së konstatoi se ai kishte statusin e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, dhe ishte e detyrueshme që ai të shkarkohej nga detyra me të njëjtat kushte me ato që zbatoheshin për një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të nenit 128 § 2(b) të Kushtetutës (shih paragrafin 44 më sipër). Megjithatë, KPA-ja rezulton të ketë gjykuar, për arsye që nuk artikulohen në vendimin e tij të datës 5 shkurt 2020, se neni 127 § 1 (d) i Kushtetutës – i cili parashikon ndërprerjen e mandatit (shkarkimi nga detyra) të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese me arsyetimin se ai ose ajo nuk ka respektuar kërkesat statutores të

përzgjedhshmërisë (po aty) – nuk zbatohet për gjyqtarët e KPA-së.

113. Së fundmi, një parregullsi në procedurën e emërimit të një gjyqtari mund të mos jetë domosdoshmërisht e hapur për t'u kundërshtuar nga një individ, duke u mbështetur në të drejtën për një “gjykatë të krijuar me ligj” në mënyrë të vazhdueshme dhe të pacilësuar. Me kalimin e kohës, ruajtja e sigurisë ligjore dhe e sigurisë së mandatit gjyqësor do të marrë rëndësi në rritje në lidhje me të drejtën e ndërgjyqësit individual për një “gjykatë të krijuar me ligj” në ushtrimin balancues që duhet të realizohet (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më sipër, §§ 252 dhe 284). Megjithatë, në çështjen konkrete, gjykatat vendëse nuk arritën asnjë balancë të cilësdo natyre.

114. Efekti i kombinuar i procedurave vendëse – veçanërisht pezullimi dhe më pas, shkarkimi i L.D. nga KPA bazuar në veprën e tij penale – mund të pengonte pretendime të tjera të ngjashme në të ardhmen. megjithatë, Gjykata nuk vlerëson se ato procedura korrigjuan ankesën e kërkuarit.

d) Përfundim

115. Gjykata ka vendosur se ekzistonte një pretendim i argumentueshëm për një shkelje të qartë të rregullit themelor të ligjit vendës, i cili ka ndikuar në mënyrë të pafavorshme në emërimin e L.D. si gjyqtari i KPA-së.

116. Për sa më sipër dhe duke pasur në konsideratë veçanërisht faktin se gjykatat vendëse nuk trajtuan në mënyrën e duhur pyetjet e ngritura nga ankuesi në lidhje me Konventën, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, për shkak se L.D. ishte pjesë e trupës gjyqësore të KPA, e cila shqyrtoi çështjen e ankuesit.

b) Në lidhje me pretendimin për mospërmbushjen e kriterëve të tjera statutores të përzgjedhshmërisë nga L.D.

117. Duke pasur në konsideratë natyrën dhe fushën e veprimtimit të shkeljes së konstatuar në mbështetje të NENIT 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e ankuesit për një gjykatë të krijuar me ligj (shih paragrafin 116 më sipër), Gjykata vendos të mos shqyrtojë pranueshmërinë dhe meritat e kësaj pjese të ankesës (shih paragrafin 77 më sipër).



II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

118. Kërkuesi parashtoi se nuk kishte pasur asnjë mjet efikas përpara një autoriteti vendës përpara të cilit të kundërshtonte shkarkimin e tij me gjasa të paligjshëm nga KPA-ja. Në këndvështrimin e tij, në mbështetje të rrethanave, kishte pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës.

119. Qeveria iu referua çështjes *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 416) dhe parashtoi se KPA-ja kishte ushtruar juridiksionin e tij të plotë në vlerësimin e të gjitha argumenteve faktike dhe ligjore të parashtruara nga kërkuesi. Në vijim, ata argumentuan se duke u shtuar procedurave të rivlerësimit një nivel të tretë të juridiksionit do të kishte komplikuar dhe zgjatur procesin.

120. Gjykata vlerëson se ankesa e kërkuesit nuk drejtohet kundër mostrajtit nga ana e autoriteteve të substancës së ankesës së tij, sipas nenit 6 § 1, në lidhje me aspektin për një “gjykatë të krijuar me ligj”, por më shumë në drejtim të mungesës së përgjithshme të mundësisë për të paraqitur një apelim kundër vendimit të KPA-së. Në përputhje me rrethanat, ankesa i bie të shqyrtohet në lidhje me ankesën, sipas nenit 8 të Konventës se shkarkimi i ankuesit nga detyra cenonte të drejtën e tij për jetë private (shih paragrafin 127 më poshtë).

121. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit, se nëse një shkelje e Konventës pretendohet të jetë kryer nga gjykata ose autoriteti më i lartë, zbatimi i nenit 13 është subjekt i një kufizimi të nënkuptuar përderisa ai nuk mund të interpretohet se kërkon që të ngrihen organe të posaçme për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve nga gjykatat më të larta (shih *Stoyanova-Tsakova kundër Bullgarisë*, nr. 17967/03, § 32, 25 qershor 2009).

122. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson, se KPA-ja është një gjykatë që përdoret si mjet i fundit në lidhje me procedurat e rivlerësimit. Në këtë mënyrë, kjo ankesë është e haptazi e pambështetur dhe duhet të rrëzohet, në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

123. Kërkuesi paraqiti një sërë ankesash të tjera në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës.

124. Fillimisht, ai u ankua se KPA-ja nuk kishte qenë një gjykatë e krijuar me ligj, duke iu referuar një mosrespektim tjetër të kriterëve statutorë të

përzgjedhshmërisë në emërimin e gjyqtarit A.H. Specifikisht, në këndvështrimin e kërkuesit, gjyqtari A.H. nuk kishte vjetërsinë e kërkuar në profesion, nota e tij mesatare e studimeve akademike ishte vetëm tetë nga dhjetë në total, nuk kishte tituj akademikë, nuk kishte pasur ndonjë eksperiencë studimore jashtë Shqipërisë dhe nuk kishte njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, siç kërkohej me ligj.

125. Së dyti, kërkuesi u ankua se gjyqtarët L.D. dhe A.H. nuk kishin paanshmërinë e nevojshme për të shqyrtuar çështjen e kërkuesit, pasi ai kishte kërkuar që të ndërpriteshin mandatet e tyre dhe kishte paraqitur një padi penale kundër L.D.

126. Së treti, kërkuesi u ankua edhe se procesi në KPA kishte qenë i padrejtë, për shkak të mosvënies së kërkuesit në dijeni të një kopje të “analizës financiare”, tek e cila gjykata ishte mbështetur për ta shkarkuar dhe e cila ka çuar në cenimin e parimit për procedura kundërshtuese.

127. Së fundmi, duke u mbështetur në të drejtën e tij për respektim të jetës së tij private, sipas nenit 8 të Konventës, kërkuesi pretendonte se vendimi i KPA-së për ta shkarkuar nga detyra kishte shkaktuar një ndërhyrje në atë të drejtë, gjë e cila nuk ishte as në përputhje me ligjin dhe as proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura.

128. Qeveria i kundërshtoi ankesat e mësipërme dhe argumentoi se nuk kishte pasur shkelje të atyre parashikimeve të Konventës.

129. Duke pasur në konsideratë natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e ankuesit për një gjykatë të krijuar me ligj (shih paragrafin 116 më sipër), Gjykata vendos të vijojë pa shqyrtuar pranueshmërinë dhe meritat e këtyre ankesave.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

130. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

A. Dëmshpërblimi

131. Ankuesi i kërkoi Gjykatës t'i akordonte dëmshpërblim monetar në shumën e barabartë me pagën e tij mujore (rreth 2200 euro (EUR)), duke mbuluar periodhën nga data e shkarkimit të tij nga



detyra deri në datën e rikthimit të tij në pozicionin e tij.

132. Në lidhje me dëmin jopasuror, kërkuksi parashtroi se dëmit ndaj imazhit dhe reputacionit të tij, si edhe stresit emocional që kishte përjetuar, nuk mund t'i vihej një vlerë monetare. Në përputhje me rrethanat, ai i kërkoj Gjykatës të akordonte shumën simbolike prej EUR 1.

133. Qeveria parashtroi se pretendimet ishin të paarsyeshme.

134. Gjykata vëren se ka konstatuar një shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas nenit 6 § 1 të Konventës pa shprehur ndonjë opinion për meritat e shkarkimit të tij. Gjykata nuk mund të spekulojë se si do të kishin qenë rezultatet e procedurave të rivlerësimit ndaj ankuesit, në rast se do të ishin respektuar kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës, dhe ajo nuk dallon ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes procedurale që ajo konstatoi dhe dëmshpërblimit monetar të pretenduar; për këtë arsye ajo e rrëzon këtë pretendim.

135. Në lidhje me dëmin jopasuror, Gjykata vlerëson se konstatimi i një shkeljeje të nenit 6 § 1 të Konventës përbën një shpërblim të drejtë për qëllimet e Konventës.

B. Kostot dhe shpenzimet

136. Ankuesi nuk parashtroi ndonjë pretendim për kostot dhe shpërblimet. Për këtë arsye, Gjykata nuk bën asnjë akordim.

V. ZBATIMI I NENIT 46 TË KONVENTËS

137. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”.

A. Parime të zbatueshme

138. Gjykata përsërit, se sipas nenit 46 të Konventës, Palët Kontraktuese kanë marrë përsipër të respektojnë vendimet e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë, teksa ekzekutimi mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave. Ajo vijon, ndër të tjera, se një vendim në të cilin Gjykata konstaton një shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj vendos detyrimin ndaj Shtetit përgjegjës, jo vetëm që të paguajë shumat e akorduara për shpërblim të drejtë, por edhe të zgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të

Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, individuale që do të miratohen në urdhrin e ligjor vendës për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga gjykata dhe për të korrigjuar sa më shumë të jetë e mundur efektet (shih *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë* [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, GJEDNJ 2000-VIII, dhe *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 36760/06, § 254, GJEDNJ 2012).

139. Në vijim, Gjykata vëren se vendimet e saj kanë natyrë thelbësisht deklarative dhe se, në përgjithësi, kryesisht i takon Shtetit konkret që të zgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, mjetet që do të përdoren në urdhrin e saj ligjor vendës për të shkarkuar detyrimin e saj, sipas nenit 46 të Konventës (shih, për shembull, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], nr. 46221/99, § 210, GJEDNJ 2005-IV), me kusht që këto mjete të respektojnë konkluzionet dhe frymën e vendimit të Gjykatës (shih, për shembull, *Scozzari dhe Giunta*, cituar më sipër, § 249, nr. 15172/13, §§ 148–49, 29 Maj 2019). Megjithatë, në rrethana të caktuara, Gjykata e ka gjykuar si të dobishme që t'i tregojë Shtetit përgjegjës llojin e masave që mund të merren për t'i dhënë fund situatës – shpesh sistematike – e cila ka çuar në konstatimin e shkeljes (shih, për shembull, *Ilgar Mammadov*, cituar më sipër, § 153).

140. Gjykata nuk ka juridiksion të urdhërojë, veçanërisht, rihapjen e procedurave (shih *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës* (nr. 2) [DHM], nr. 32772/02, § 89, GJEDNJ 2009). Megjithatë, ashtu siç pohohet në rekomandimin nr. R (2000)2 të Komitetit të Ministrave, praktika e Komitetit të Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës tregon se në rrethana përjashtuese, rishqyrtimi i një çështjeje ose rihapja e procedurave ka provuar të jetë mjeti më efikas, në mos i vetmi, për të arritur *restitutio in integrum* (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) [DHM], nr. 19867/12, § 48, 11 korrik 2017).

141. Në një sërë çështjesh në të cilat Gjykata ka konstatuar një shkelje të së drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj, ajo ka vlerësuar se forma më e përshtatshme e korrigjimit do të ishte rigjykimi ose rihapja e procedurave vendëse (shih *Ilavskij kundër Rusisë*, nr. 6945/04, § 49, 9 korrik 2009; *Momčilović kundër Serbisë*, nr. 23103/07, § 41, 2 prill 2013; *Ezgeta kundër Kroacisë*, nr. 40562/12, § 49, 7 Shtator 2017; *Gurov kundër Moldavisë*, nr. 36455/02, § 43, 11



korrik 2006; dhe *Zeynalov kundër Azerbajxhanit*, nr. 31848/07, § 41, 30 maj 2013).

142. Në çështje të tjera, Gjykata e ka lënë në diskrecionin e autoriteteve vendëse që të vendosin nëse do t'i rihapin procedurat (shih, për shembull, *Chim dhe Przywiezierski kundër Polonisë*, nr. 36661/07 dhe 38433/07, § 219, 12 prill 2018, dhe *Dolińska-Ficek dhe Ożimek*, cituar më sipër, § 368), ose ka miratuar masat e tyre me synimin për të bashkërenduar respektin për të drejtat e individëve, sipas nenit 6 § 1 të Konventës me parimet për sigurinë ligjore, respektin për *res judicata* dhe aspekte të tjera në lidhje me rrethanat konkrete (shih *Advance Pharma sp. Z o.o.*, cituar më sipër, §§ 127 dhe 365).

143. Së fundmi, pas vendimit të Gjykatës në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më sipër), Gjykata, në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) të Konventës, vendosi të heqë nga lista e saj e çështjeve dy kërkesa të ngjashme kundër Islandës, me arsyetimin se Qeveria përgjegjëse e kishte njohur shkeljen për të cilën ishte bërë ankesa, dhe se ekzistonte një mundësi reale që procedurat vendëse do të rihapeshin (shih *Friðjón Björgvin Gunnarsson kundër Islandës* (vendim), nr. 6696/19, §§ 11–12, 2 qershor 2022).

B. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

144. Në lidhje me masat e përgjithshme, Gjykata vlerëson se L.D. u pezullua nga ushtrimi i funksioneve të tij si gjyqtar i KPA-së, më 24 korrik 2020, dhe u largua në mënyrë të përhershme nga ajo detyrë më 31 maj 2021 (shih paragrafin 114 më sipër). Gjithashtu, Gjykata përsërit se konstatimi i një shkelje në të drejtën për një gjykatë të krijuar me ligj në çështjen konkrete, në vetvete, mund të mos merret si shkak për të ushtruar një detyrim sipas Konventës ndaj Shtetit përgjegjës për të rihapur të gjitha çështjet e ngjashme të cilat janë bërë *res judicata* sipas ligjit vendës (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më sipër, § 314, dhe paragrafi 88 më sipër).

145. Duke u kthyer te masat individuale, Gjykata fillimisht vlerëson se procedurat e rivlerësimit për ankuesin kryesisht kishin të bënin me të drejtat dhe detyrimet e tij si prokuror karriere dhe nuk kishin implikime, të paktën drejtpërdrejtë, për të drejtat dhe detyrimet e ndonjë pale të tretë. Gjithashtu, është e qartë se rezultati i atyre procedurave, të cilat rezultuan në shkarkimin e tij të

menjëhershëm nga detyra dhe në detyrimin statutor, që e ndalonte në mënyrë të përhershme të rikthehej në pozicionin e magjistratit (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 363), kishin pasoja serioze për karrierën e tij profesionale.

146. Qeveria deklaroi se sipas ligjit vendës, nuk ishte plotësisht e qartë nëse do të kishte një rihapje të procesit të rivlerësimit.

147. Nga ana tjetër, Qeveria parashitroi se në ligjin vendës nuk ekzistonte ndonjë parashikim specifik i cili lejonte rihapjen e procesit të rivlerësimit. Qeveria sugjeroi se kjo mund të kishte qenë një zgjedhje e qëllimshme nga ana e legjislativit, pasi procesi i rivlerësimit ishte i kufizuar në aspektin kohor dhe rihapja e tij mund ta komplikonte procesin. Gjithashtu, Qeveria pohoi se neni F § 8 i aneksit të Kushtetutës, i cili parashikonte se personat e rivlerësuar kishin të drejtën të ushtronin ankim në Gjykatë, mund të interpretohej si tregues i qëllimit të legjislativit për të përjashtuar mundësinë e rihapjes së kërkesave për procedurat të cilat ishin përmbyllur me anë të vendimeve të KPA-së.

148. Nga ana tjetër, Qeveria iu referua detyrimit të Shtetit për të respektuar ligjin ndërkombëtar detyrues. Gjithashtu, Qeveria theksoi se neni 494(ë) i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 71/c i ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafët 49, 56 dhe 57 më sipër) parashikonin rihapjen e procedurave civile dhe kushtetuese, respektivisht, pas konstatimit nga ana e Gjykatës së një shkelje, sipas kushteve të parashikuara në atë nen. Këto parashikime mund të shërbenin potencialisht si baza për rihapjen e procedurave konkrete, dhe në një rast të tillë, sipas këndvështrimit të Qeverisë, KPA do të ishte organi me juridiksionin për t'i marrë në konsideratë ato kërkesa.

149. Gjykata mban në konsideratë qëndrimin e Qeverisë, se mund të ketë një rrugë ligjore për ankuesin që të kërkojë rihapjen e procedurave. Në këtë mënyrë, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, dhe pikën deri ku kjo gjë mund të jetë e mundur sipas ligjit vendës, forma më e përshtatshme e korrigjimit për shkeljen e së drejtës së kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas nenit 6 § 1 të Konventës do të ishte rihapja e procedurave, nëse ankuesi e kërkonte një rihapje të tillë, si edhe rishqyrtimi i çështjes në një mënyrë e cila i përmbahet të gjitha kërkesave të nenit 6 § 1 të Konventës.



150. Së fundmi, ankuesi kërkoi që Gjykata të prishte vendimin e KPA-së, të datës 27 shkurt 2020, dhe i kërkonte Qeverisë që ta rikthente në detyrën e tij të mëparshme menjëherë. Sipas juridiksionit të saj (shih paragrafin 139 më sipër) dhe natyrës së shkeljes, e cila u konstatua në lidhje me procedurat e rivlerësimit të kërkuesit, Gjykata e refuzon këtë kërkesë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. *E deklaron*, unanimisht, ankesën bërë në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj” të pranueshme, dhe ankesën në bazë të nenit 13 të Konventës në lidhje me mungesën e një mjeti efektiv ndaj vendimit të KPA-së, të papranueshme;

2. *Vlerëson*, unanimisht, se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës në lidhje me të drejtën e ankuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”;

3. *Vlerëson*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e tjera sipas nenit 6 § 1 dhe 8 të Konventës;

4. *Rrëzon*, unanimisht, pretendimin e ankuesit për shpërblim të drejtë për sa i përket shpërblimit monetar;

5. *Vlerëson*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se konstatimi i shkeljes përbën shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për sa i përket shpërblimit jopasuror.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 4 tetor 2022, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Georges Ravarani
KRYETAR

Milan Blaško
SEKRETAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës, dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinionin i veçuar i Gjyqtarit Serghides i aneksohet këtij vendimi.

G.R.
M.B.

MENDIMI PJESËRISHT DAKORDËSUES DHE PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

I. Hyrje

1. Kjo çështje, kryesisht, ka të bëjë me ankesën e kërkuesit se shkarkimi i tij nga detyra si prokuror nga Kolegji i Posaçëm i Apelit cenonte të drejtën e tij për një gjykim të drejtë, sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Kjo për shkakun, sepse Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj”, pasi njëri prej gjyqtarëve i cili u ul në atë Kolegj dhe gjykoi çështjen e tij ishte emëruar në atë pozicion në shkelje të një kriteri statutor për përzgjedhshmërinë.

Duhet të theksohet se në çështjen *DMD GROUP, a.s.v. kundër Sllovakisë* (nr. 19334/03, § 58, 5 tetor 2010), Gjykata vlerësonte se “sipas nenit 6 § 1 të Konventës, një gjykatë duhet të krijohet gjithmonë me ligj dhe, se “ky përcaktim reflekton parimin e shtetit të së drejtës, i cili është pjesë e qenësishme në sistemin e mbrojtjes parashikuar nga Konventa dhe Protokollet e saj”.

2. Duke deklaruar pozicionin tim në lidhje me parashikimet operative të vendimit, unë jam dakord me pikat 1, 2 dhe 4, dhe me respekt, nuk jam dakord me pikat 3 dhe 5. Më poshtë do të shpjegoj arsyet e mia se përse nuk jam dakord.

II. Pasojat e konstatimit se nuk ekziston një “gjykatë e krijuar me ligj”

3. Unë, nuk jam dakord, veçanërisht, me paragrafin 129 të vendimit dhe pikën respektive numër 3 të parashikimeve të tij operative, më konkretisht, sepse për shkak të konstatimit se nuk ka një “gjykatë të krijuar me ligj”, nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa tjetër e ankesave sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 8 të Konventës. Në opinionin tim, pas konstatimit se nuk ekziston një “gjykatë e krijuar me ligj”, “ankesat e tjera” të pretenduara shpëputen menjëherë dhe automatikisht nga objekti dhe ekzistenca *ex tunc* dhe, për këtë arsye, ato do të duhej të ishin kundërshtuar si të papranueshme *ratione materiae*, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës. Mungesa e një “gjykate të krijuar me ligj” kishte dy lloje pasojash në lidhje me nenin 6, fillimisht duke e bërë të gjithë gjykimin të padrejtë, dhe së dyti, duke i bërë çdo ankesë tjetër sipas këtij parashikimi të papranueshme *ratione materiae*. Nga ana tjetër, mungesa e garancive të nenit 6 mund ta bëjë të



gjithë gjykimin të padrejtë, por nuk mund të bëjë ankesat e tjera sipas nenit 6 të papranueshme *ratione materiae*.

4. Në të vërtetë, qasja e vendimit në çështjen konkrete është e ngjashme me vendimin për çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* ([DHM], nr. 26374/18, § 295, dhe pika 2 e pjesës operative, 1 dhjetor 2020), ku, pas konstatimit se nuk kishte pasur një “gjykatë të krijuar me ligj” – një garanci e parashikuar në nenin 6 – Gjykata vendosi me shumicë se nuk ishte “e nevojshme të shqyrtohej pjesa tjetër e ankimeve sipas nenit 6 § 1”, që kishte të bënte me ankesat ku pretendoheshin mungesa e pavarësisë dhe e paanshmërisë së një gjykate.

5. Megjithatë, në opinionin tim pjesërisht kundërshtues në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson*, unë nuk isha dakord me shumicën se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ankesat e tjera, dhe unë propozova se pas konstatimit se nuk kishte gjykatë të krijuar me ligj, “ankesat e tjera” të pretenduara, më konkretisht ato që kishin të bënin me garancitë e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, shkëputeshin menjëherë dhe automatikisht nga objekti dhe ekzistenca *ex tunc*, dhe për këtë arsye at do të duhej të ishin rrëzuar si të papranueshme *ratione materiae*, sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës¹. Unë argumentova² edhe se nëse nuk ekziston një “gjykatë”, siç ishte edhe konstatimi i Gjykatës në atë çështje, për shkak të mungesës së një gjykate të krijuar me ligj, nuk ekziston emri, dhe në këtë mënyrë as objekti, të cilit mund t’i vendosen mbiemrat “i pavarur” dhe “i paanshëm”, duke rezultuar në shkëputjen e këtyre mbiemrave nga objekti dhe ekzistenca. Të gjitha kërkesat e së drejtës për një gjykim të drejtë të parashikuara në nenin 6 § 1 janë të domosdoshme, dhe pa ato nuk mund të sigurohet ajo e drejtë. Megjithatë, e vetmja kërkesë e pavarur e nenit 6 § 1 është se ekzistenca e një gjykate të ligjshme. Kjo kërkesë është një element *qendror* për një gjykim të drejtë, pasi i referohet *vet thelbit* të së drejtës përkatëse. Të gjitha kërkesat e nenit 6 § 1 presupozojnë përmbushjen e kësaj kërkesë qendrore, krijimin e një gjykate me ligj. Me fjalë të tjera, kërkesat/garancitë për “pavarësi” dhe “paanshmëri” janë cilësi thelbësore dhe të pandara

që kanë të bëjnë me vet ekzistencën e një “gjykate të krijuar me ligj”. Është e pamundur që të shqyrtohen cilësitë e një gjykate që nuk ekziston, ashtu siç është e pamundur që të shqyrtohen cilësitë e një personi ose ndërtese inekzistente. Për këtë arsye, çdo shpresë që një gjykatë të jetë e pavarur dhe e paanshme do të varet nga fakti nëse, fillimisht, ajo është një gjykatë e krijuar me ligj. Cilësitë e mëparshme varen nga të dytat dhe nuk mund të lihen në ajër. Fatkeqësisht, Gjykata në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson*, duke konstatuar se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ankesat për mungesën e pavarësisë dhe të paanshmërisë, dha përshtypjen se ajo po u referohej meritave të atyre ankesave, duke sugjeruar në këtë mënyrë se ato mbeteshin të pranueshme. Megjithatë, siç shprehet edhe në këtë opinion, këto ankesa ishin bërë të papranueshme dhe duhej të rrëzoheshin si të tilla.

6. Unë pata mundësinë që të shpjegoja dhe të detajoja më tej qasjen që ndoqa në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson* dhe në çështjen konkrete, në opinionin tim kundërshtues në çështjen *Angerjäv dhe Greinoman kundër Estonisë* (nr. 16358/18 dhe 34964/18, 4 tetor 2022 – një vendim i shpallur në të njëjtën datë me vendimin konkret). Shkurtimisht, unë parashtrova në atë opinion se duhet të ketë një hierarki garancish në nenin 6 dhe se garancia për një “gjykatë të krijuar me ligj” duhet të vendoset në krye të hierarkisë³. Gjithashtu, unë parashtrova se, duke qenë se garancitë e së drejtës për një gjykim të drejtë, sipas nenit 6, janë elemente të kësaj të drejte, parimit të efikasitetit, për të përmbushur qëllimin e tij, duhet të ndihmojnë në dhënien e këtyre garancive – në çështjen konkrete garancia për një “gjykatë të krijuar me ligj” – të peshës dhe efektit të tyre të plotë dhe pasojat e tyre përkatëse të plota sipas normës së efikasitetit⁴.

7. Një çështje mbetet për t’u shqyrtuar në lidhje me këtë aspekt, më konkretisht ajo e pasojave të mungesës së garancisë së nenit 6 për një “gjykatë të krijuar me ligj” për pjesën tjetër të ankesave. Duhet të theksohet se pjesa tjetër e ankesave në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson* kishte ankesa që kishin të bënin me nenin 6 – veçanërisht, me mungesën e garancive të pavarësisë së një gjykate dhe të

¹ Shih paragrafin 4 të opinionit.

² Po aty, në paragrafin 5.

³ Shih paragrafin 28 të atij opinionit.

⁴ Shih paragrafët 30–31 të atij opinionit.



paanshmërisë së gjykatës. Në çështjen konkrete, megjithatë, ankesat e tjera kishin të bënin si me ankesat sipas nenit 6 dhe një ankesë sipas nenit 8 të Konventës. Siç theksohet në paragrafin 127 të vendimit, duke u mbështetur në këtë të drejtë për respektimin e jetës private, sipas nenit 8 të Konventës, kërkuesi pretendonte se vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për ta shkarkuar atë nga detyra kishte shkaktuar një ndërhyrje në atë të drejtë, e cila nuk ishte as në përputhje me atë ligj dhe as proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura. Për këtë arsye, pyetja që ngrihet është nëse qasja ime në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson*, më konkretisht që ankesat e tjera sipas nenit 6 ishin të papranueshme *ratione materiae*, zbatohet edhe në lidhje me ankesën sipas nenit 8, e cila është një e drejtë reale.

8. Duhet të bëhet e qartë se ankesa sipas nenit 8 nuk mund të shpërblehet nga ankesa se nuk ekzistonte një gjykatë e krijuar me ligj sipas nenit 6. Shkelja e pretenduar e nenit 8 nuk ekzistonte përpara shkeljes së pretenduar të nenit 6 (që do të thotë, se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ishte një gjykatë e krijuar me ligj), dhe nuk ishte as e pavarur nga ajo ankesë. Përkundrazi, ankesa për shkeljen e së drejtës për jetë private, sipas nenit 8 ishte një përfundim i drejtpërdrejtë i shkeljes së të drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj sipas nenit 6. Nëse shkelja e pretenduar e nenit 6 do të ekzistonte paraprakisht ose do të kishte qenë e pavarur nga shkelja sipas nenit 6, çështja do të kishte qenë ndryshe.

9. Kështu, në mendimin tim, ndikimi i mungesës së garancisë për një “gjykatë të krijuar me ligj” në ankesën bërë sipas nenit 8 do të ishte e njëjtë si ajo e ankesave të tjera, sipas nenit 6, duke i bërë të gjitha ato ankesa të papranueshme *ratione materiae* dhe duke sjellë rrëzimin e tyre, dhe duke qenë se të gjitha ato ankesa të tjera janë automatikisht të papranueshme, si rezultat i konstatimit se nuk ekzistonte një gjykatë e krijuar me ligj, në opinionin tim nuk është korrekte, apo të paktën e saktë, të thuhet, ashtu siç shprehet vendimi, se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen ato ankesa. Kjo papranueshmëri e dukshme dhe automatike duhej të ishte njohur menjëherë dhe të ishte deklaruar nga Gjykata si e tillë, dhe Gjykata nuk duhej të thoshte thjesht se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ankesat e tjera.

III. Konstatimi i shkeljes në vetvete nuk është shpërblim i drejtë i përshtatshëm

10. Me respekt, unë nuk bie dakord me paragrafin 135 të vendimit dhe pikën korresponduese 5 të parashikimeve të tij operative, më konkretisht, se konstatimi i shkeljes ndaj nenit 6 § 1 të Konventës përbënte shpërblim të drejtë të përshtatshëm apo të mjaftueshëm për qëllimet e Konventës, veçanërisht për sa kishte të bënte me shpërblimin jopasuror. Siç kam parashtruar edhe në opinionet e tjera, neni 41 i Konventës, në formulimin e tij, nuk mund të interpretohet me kuptimin se konstatimi i shkeljes së parashikimit të Konventës në vetvete mund të përbënte mjaftueshëm “shpërblim të drejtë për palën e dëmtuar”. Kjo për arsyen se i pari është një parakusht për të dytin dhe ata nuk mund të konsiderohen si nene të njëjta (shih paragrafët 5–9 të opinionëve të mia kundërshtuese me Gjyqtarin Felici në çështjen *Grzegda kundër Polonisë* [DHM], nr. 43572/18, 15 mars 2022; paragrafi 2 i opinionit tim pjesërisht kundërshtues në çështjen *Assemblée chrétienne des Témoins de Jéhovah d’Anderlecht dhe të Tjerët kundër Belgjikës*, nr. 20165/20, 5 prill 2022; dhe paragrafi 9 i opinionit tim pjesërisht kundërshtues në çështjen *Abdi Ibrahim kundër Norvegjisë* [DHM], nr. 15379/16, 10 dhjetor 2021).

Mosakordimi për ankuesin i një shume për dëmin jopasuror, në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij, sipas mendimit tim, e bën mbrojtjen e të drejtave të tij zhgënjyese dhe fiktive (shih, me të njëjtin efekt, opinionet referuar më sipër). Kjo është në kundërshtim me praktikën gjyqësore, duke bërë që mbrojtja e të drejtave të njeriut duhej të ishte praktike dhe efikase dhe joteorike dhe zhgënjyese, siç edhe kërkohej nga parimi i efikasitetit, i cili është pjesë thelbësore e Konventës (shih *Artico kundër Italisë*, 13 maj 1980, §§ 33 dhe 47–48, seritë A, nr. 37).

11. Nëse kërkuesi nuk do të kishte kërkuar t’i akordohej shuma simbolike prej 1 eurosh për dëmin jopasuror (shih paragrafin 132 të vendimit), dhe nëse unë nuk do të isha në minorancë, unë do t’i kisha akorduar ankuesit një shumë të rëndësishme për dëmin jopasuror. Megjithatë, duke qenë se çështja ka të bëjë me dëmin jopasuror dhe sipas rregullit *non ultra petita* (jo përtej kërkesës), përfundimisht, unë do t’i kisha akorduar atë çfarë ai kërkoj, dhe nuk do të kisha zbatuar as kriterin e pranueshmërisë në nenin 35 § 3 (b) (asnjë



disavantazh i rëndësishëm), dhe as rregullin *de minimis non curat praetor* (gjykata nuk merret me vogëlsira).

IV. Përfundim

12. Sa më sipër, unë arrij në përfundimin, në lidhje me pikat mbi të cilat unë ndryshoja nga shumica, se: a) duke konstatuar se nuk ekziston një “gjykatë e krijuar me ligj”, ankesat e tjera ishin automatikisht të papranueshme *ratione materiae* dhe, për këtë arsye, Gjykata duhej të kishte nxjerrë një përfundim për këtë aspekt dhe të mos i linte të pavendosura; dhe b) se ankuesit duhej t’i ishte akorduar shuma simbolike e kërkuar prej tij për dëmin jopasuror.

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (DSIK)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar; në VKM-në nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”; dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017, “Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) në DSIK ka deklasifikuar raportet e Grupit të Punës (GP), informacione të klasifikuara “Sekret shtetëror”, të nivelit “Sekret”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP-së nr. 12347, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Elveta Besim Murra”.

2. Raport i GP-së nr. 11822, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Mariola Josif Mërtiri”.

3. Raport i GP-së nr. 12119, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Alfred Luan Sali”.

4. Raport i GP-së nr. 11823, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Marsida Bashkim Frashëri”.

5. Raportet e GP nr. 12416, datë 2.11.2017 me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Flutura Bilal Hoxha”.

6. Raport i GP-së nr. 10700, datë 24.11.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Gjergji Pavlo Tako”.

7. Raport i GP-së nr. 12002, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Majlinda Kujtim Tosku”.

8. Raport i GP-së nr. 12547, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Erarbër Alfred Madhi”.

9. Raport i GP-së nr. 287, datë 17.1.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Edmond Halil Kariqi”.

10. Raport i GP-së nr. 11401, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Elsa Sabahudin Kareçi”.

11. Raport i GP-së nr. 11810, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Arian Astrit Përmeti”.

12. Raport i GP-së nr. 12323, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Petref Demir Asllani”.

13. Raport i GP-së nr. 11744, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Elizabeta Avdi Imeraj”.

14. Raport i GP-së nr. 12317, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Arian Zef Ndoja”.

15. Raport i GP-së nr. 11813, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Erjon Sami Shqarri”.

16. Raport i GP-së nr. 11756, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Bajram Ukshin Breçani”.



17. Raport i GP-së nr. 11711, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Nurjeta Petrit Tafa”.

18. Raport i GP-së nr. 11690, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Hysen Përparim Ajasllari”.

19. Raport i GP-së nr. 11696, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Armand Sabri Gurakuqi”.

20. Raport i GP-së nr. 11731, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Armela Artur Hasantari”.

21. Raport i GP-së nr. 11611, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Mihallaq Jorgji Bleta”.

22. Raport i GP-së nr. 11410, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Arben Flamur Mickaj (Micko)”.

23. Raport i GP-së nr. 11867, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Ervisa Kadri Hyka”.

24. Raport i GP-së nr. 12135, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Naim Baftjar Tota”.

25. Raport i GP-së nr. 11797, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Ervin Shpëtim Pollozhani”.

26. Raport i GP-së nr. 11403, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Ida Muhamet Ahmetli”.

27. Raport i GP-së nr. 12250, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Artan Ilir Jahollari”.

28. Raport i GP-së nr. 11868, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Arjana Pleurat Gumbardhi (Caco)”.

29. Raport i GP-së nr. 12295, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e

figurës së subjektit të rivlerësimit z. Andri Faik Ymeri”.

30. Raport i GP-së nr. 11755, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Blerina Gëzim Muço”.

31. Raport i GP-së nr. 11415, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Deniona Sotir Katro (Katra)”.

32. Raport i GP-së nr. 12276, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Julian Elez Xhengo”.

33. Raport i GP-së nr. 4422, datë 23.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Sokol Ali Pasho”.

34. Raport i GP-së nr. 12409, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Eglantina Llazi Mikani”.

35. Raport i GP-së nr. 12373, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Asllan Xhezmi Barjamaj”.

36. Raportet e GP-së nr. 12345, datë 2.11.2017 si dhe raporti Nr. 5697, datë 03.08.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Znj. Teuta Thoma Rrudha (Prifti)”.

37. Raport i GP-së nr. 12459, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Edvan Eduart Veçani”.

38. Raport i GP-së nr. 11735, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Luljeta Thanasi Kole”.

39. Raport i GP-së nr. 12464, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Genci Shuaip Mane”.

40. Raport i GP-së nr. 12406, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Ilir Besnik Turja”.

41. Raport i GP-së nr. 11560, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Suela Paskal Beluli”.



42. Raport i GP-së nr. 11610, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Kasem Daver Berberi”.

43. Raport i GP-së nr. 12512, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Vladimir Maliq Skënderi”.

44. Raport i GP-së nr. 11698, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Besnik Gani Cengu”.

45. Raport i GP-së nr. 11999, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Enida Agron Lamçe”.

46. Raport i GP-së nr. 12540, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Petraq Arqile Çuri”.

47. Raport i GP-së nr. 12001, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Yrfet Hasan Shkreli”.

48. Raport i GP-së nr. 12316, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Luljeta Hasan Kolonja”.

49. Raport i GP-së nr. 12300, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Belina Ramazan Kryemadhi”.

50. Raport i GP-së nr. 12077, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Aida Bashkim Cakaj”.

51. Raport i GP-së nr. 12051, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Avni Riza Sejdi”.

52. Raport i GP-së nr. 12465, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Agron Syrri Bushati”.

53. Raport i GP-së nr. 12527, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Orela Fahri Troplini”.

54. Raport i GP-së nr. 12117, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e

figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Oltiana Jovan Gjoni (Çifliku)”.

55. Raport i GP-së nr. 12389, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Neritan Ramis Hoxha”.

56. Raport i GP-së nr. 12000, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Saimir Zenel Hysa”.

57. Raport i GP-së nr. 12062, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Vjola Resmi Canaj”.

58. Raport i GP-së nr. 11559, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Zeta (Zenepe) Rakip Tërpollari”.

59. Raport i GP-së nr. 11778, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Armida Llazi Hamiti”.

60. Raport i GP-së nr. 12076, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Gentiana Ali Muçaj (Qeseja)”.

61. Raport i GP-së nr. 12456, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Lazër Lin Sallaku”.

62. Raport i GP-së nr. 12252, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Sokol Jonus Malaj”.

63. Raport i GP-së nr. 11811, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Arta Kosta Llazari”.

64. Raport i GP-së nr. 12510, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Markelian Spiro Koça”.

65. Raport i GP-së nr. 12341, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Dritan Nikollaq Nushi”.

66. Raport i GP-së nr. 11997, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Miranda Nikollë Bushi (Hysa)”.



67. Raport i GP-së nr. 12009, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Vitjuna Miltiadh Tërpollari (Mata)”.

68. Raport i GP-së nr. 11673, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Antonela Vladimir Prendi”.

69. Raport i GP-së nr. 11779, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Sokol Faik Nishani”.

70. Raport i GP-së nr. 11798, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Arben Foto Kostandini”.

71. Raport i GP-së nr. 11412, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Dritan Esat Caka”.

72. Raport i GP-së nr. 11584, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Urim Halim Buci”.

b) Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP-së nr. 5698, datë 3.8.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Alfred Spiro Konomi”.

2. Raport i GP-së nr. 8795, datë 26.9.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Andri Faik Ymeri”.

3. Raport i GP-së nr. 3498, datë 20.5.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Arbër Isuf Çela”.

4. Raport i GP-së nr. 4428, datë 27.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Asllan Xhezmi Barjama”.

5. Raport i GP-së nr. 1267, datë 2.3.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Besnik Nuh Hoxha”.

6. Raport i GP-së nr. 9902, datë 3.11.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Ded Pjetër Miri”.

7. Raport i GP-së nr. 4493, datë 27.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Eglantina Llazi Mikani”.

8. Raport i GP-së nr. 9360, datë 13.10.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Elidon Luftar Hysenaj”.

9. Raport i GP-së nr. 4191, datë 21.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Elio Halit Mazreku”.

10. Raport i GP-së nr. 3572, datë 23.5.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Elsa Abaz Ulliri”.

11. Raport i GP-së nr. 1265, datë 2.3.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Emror Haxhi Kasaj”.

12. Raport i GP-së nr. 11313, datë 23.12.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Erind Tomor Reovica”.

13. Raport i GP-së nr. 8401, datë 20.9.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Etleva Skënder Gjamo”.

14. Raport i GP-së nr. 1266, datë 2.3.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Florian Aktor Bonjaku”.

15. Raport i GP-së nr. 4429, datë 24.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Genci Shuaip Mane”.

16. Raport i GP-së nr. 10008, datë 7.11.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Hyrjet Vexhi Lamaj”.

17. Raport i GP-së nr. 7782, datë 17.08.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Ilir Besnik Turja”.

18. Raport i GP-së nr. 12441, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Ilir Gani Hoxha”.

19. Raport i GP-së nr. 9738, datë 26.10.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Markelian Spiro Koça”.

20. Raport i GP-së nr. 12479, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Marsela Petrit Balili”.

21. Raport i GP-së nr. 8035, datë 29.8.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Merita Mersin Selimi”.



22. Raport i GP-së nr. 10701, datë 24.11.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Pajtime Halit Fetah”.

23. Raport i GP-së nr. 4192, datë 21.6.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Paulin Nazif Çera”.

24. Raport i GP-së nr. 2916, datë 29.4.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Pëllumb Ferit Zaimi”.

25. Raport i GP-së nr. 8034, datë 29.8.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Rexhina Ferrok Merlika”.

26. Raport i GP-së nr. 9627, datë 24.10.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Robert Spiro Kote”.

27. Raport i GP-së nr. 9188, datë 10.10.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Saimir Tahir Bahiti”.

28. Raport i GP-së nr. 488, datë 24.1.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Shpëtim Adem Reka (Eleza)”.

29. Raport i GP-së nr. 9197, datë 11.10.2022, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Vladimir Maliq Skënderi”.

c) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në *web* të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 337, datë 21.12.2022

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS,
NDËRMJET SHOQËRIVE KESH SHA
DHE FTL SHA, PËR SHITJEN/
BLERJEN/DEPOZITIMIN/SHKËMBIMI
N E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 47, 56, germa “f”, si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pjesës

I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; kapitullit V të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”; “Kodit të Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/6 prot., datë 19.12.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 273, datë 27.10.2022, vendosi që KESH sh.a. dhe FTL sh.a. të rishikojnë kontratën e përcjellë në ERE, bazën ligjore dhe nenin 8 të kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022–31.12.2022.

- Shoqëritë KESH–FTL, me shkresën nr. 1745/1 prot., datë 7.12.2022, dërguan në ERE kontratën tip, mes shoqërisë KESH–FTL, me nr. 5996 prot., datë 7.12.2022, të KESH sh.a. dhe nr. 2780/1 prot., datë 7.12.2022 të FTL sh.a., me ndërhyrjet sipas konstatimeve dhe përmbajtjes së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 273, datë 27.10.2022, si dhe sqarimet respektivisht si më poshtë vijon:

- Lidhur me këtë pikë, shoqëritë kanë sqaruar se në zbatim të parashikimeve të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, konkretisht nenit 15, “Dispozita kalimtare”, pika 2, ngarkohen shoqëritë KESH sh.a., FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe FTL sh.a., që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të rakordojnë sasisë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.

- Konkretisht, marrëdhënia kontraktore mes palëve do të fillojë zbatimin nga momenti i hyrjes



në fuqi të vendimit nr. 456/2022, me sasi energjie të depozituar/shkëmbyer, sipas rakordimit të realizuar nga ana e palëve.

- Nga shqyrtimi i kontratës vlerësohet, se:

- Në bazën ligjore të kontratës të sjellë për miratim në ERE të shtohen dhe këto akte ligjore:

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, të ndryshuar;

- Vendimi nr. 198, datë 3.9.2018, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a. (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi nr. 253, datë 21.12.2021, i Bordit të ERE-s, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”.

- Neni 8, “Parashikime kalimtare”, vlerësohet të ndryshojë, si më poshtë:

1. Palët, me miratimin e kësaj kontrate, bazuar në parashikimet e pikës 2, të nenit 15, të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, pas nënshkrimit ndërmjet tyre, rakordojnë sasinë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.

- Në nenin 8 vlerësohet të shtohet pika 3, si më poshtë vijon:

3. Ky rakordim mbyllet jo më vonë se datë 10.1.2023.

- Neni 9, “Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme”, pika 1 vlerësohet të ndryshojë, si më poshtë:

1. Kjo kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ERE.

- Neni i fundit i kontratës, neni 9, të ndryshojë dhe të bëhet neni 10, pasi neni 9 përsëritet dy herë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a. për shitjen / blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike (bashkëlidhur).

2. Kontrata e nënshkruar nga Palët të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mos-marrëveshjeve të njoftojë te shoqëritë KESH sh.a., dhe FTL sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Nr. _____ prot, datë ____/____/2022

Nr. _____ prot, datë ____/____/2022

Kontratë ndërmjet KESH sh.a dhe FTL sh.a. për periudhën dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv**E lidhur sot me datë _____.2022, ndërmjet:**

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, date 06.11.1995 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, me seli ne Rr.”Viktor Eftimiu”, Blloku Vasil Shanto, Tirane, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga Erina REXHEPI, Administrator i Shoqërisë KESH sh.a., qe me poshtë do te quhet “**Shitësi/Blerësi/ Depozituesi**”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., shoqëri aksionere, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori Ergys VERDHO, qe me poshtë do të quhet “**Blerësi/Shitësi ose Depozitdhënësi**”,

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore: Ligji Nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Vendimi Nr. 584, datë 08.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, i ndryshuar.

Në kushtet kur:

- Në nenin 12, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022 parashikohet trajtim i tepricave të energjisë elektrike të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, të cilat depozitohen te shoqëria publike e prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të “OSSH” SH.A., deri në mbulimin e plotë të tyre.
- Në nenin 5, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022 parashikohet trajtim i tepricave të prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria publike, për qëllim të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së “OSSH” SH.A.
- Deri në hyrjen në fuqi të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave, detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënie mes shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal rregulloheshin nga Vendimi i këshillit të Ministrave Nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar.
- Në dispozitat kalimtare të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022 të Këshillit të ministrave, parashikohet që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të rakordojnë sasitë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit, për vitin ushtrimor 2022.
- Është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike përgjatë gjithë vitit 2022.



Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

“KESH” dhe “FTL” lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë për shitje/blerje/depozitim/shkëmbimin të energjisë elektrike me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, sipas rasteve të mëposhtme:

1. KESH sh.a., do të quhet “Shitësi” dhe FTL sh.a. do të quhet “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike që evidentohet si tepricë e energjisë elektrike mbas mbylljes së bilancit që ka patur destinacion plotësimin e kërkesës për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2022-31.12.2022.
2. FTL sh.a. do të quhet “Depozitdhënësi” dhe KESH “Depozituesi”, për atë sasi të energjisë elektrike e evidentuar si tepricë të energjisë elektrike nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Kjo sasi e energjisë elektrike e depozituar do të kthehet/shkëmbet shoqërisë FTL sh.a. për plotësimin e kërkesës për humbjet në rrjetin e shpërndarjes brenda vitit kalendarik.
3. FTL sh.a., do të quhet “Shitësi” dhe KESH sh.a. “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike e cila evidentohet në fund të vitit kalendarik e pa kompensuar me energji elektrike për mbulimin e humbjeve, dhe ku FTL ia shet KESH me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
4. Sasitë e energjisë të shitura/blera/depozituara/shkëmbyera, në zbatim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 15 të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, rakordohet mes palëve bazuar në të dhënat faktike. Në procesin e rakordimit sasia e energjisë elektrike të depozituar do të jetë ajo sasi e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë së alokuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Palët kujdesen që gjatë procesit të depozitimit/shkëmbimit, të rakordojnë çdo muaj në përputhje me dispozitat e mësipërme për saktësimin e sasisë së energjisë së depozituar/shkëmbyer. Periudha nga Janari deri në Gusht 2022 do të rakordohet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas të dhënave faktike të kësaj periudhe.

Neni 2

Detyrimet Kryesore të Palëve

1. FTL SH.A. përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të konfirmojë me KESH SH.A. sasitë gjendje të energjisë elektrike të depozituara, si dhe do të informojë KESH SH.A. për sasinë që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar KESH SH.A. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për ta furnizuar me sasi energjie elektrike nga prodhimi i kaskadës.
2. FTL SH.A. çdo muaj/javë/ditë në avancë planifikon tepricat e pritshme të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe do t'i dërgojë në rrugë elektronike shoqërisë KESH SH.A. për t'i depozituar/shitur, si më poshtë:
 - çdo ditë të enjte informacionin për javën në avancë në profil 24 orë;
 - brenda orës 15:00 informacion të përditësuar për ditën D+2 në profil 24 orë;
 - brenda orës 12:00 informacion për ditën D në profil 24 orë.
3. FTL SH.A. pas mbylljes së bilancit energjitik dërgon në KESH SH.A. të dhëna për:
 - (i) sasinë faktike të prodhimit nga burimet e rinovueshme;
 - (ii) sasinë e energjisë që është importuar nga FTL për mbulimin e humbjeve.
 - (iii) sasinë faktike të energjisë e cila është përdorur për mbulimin e humbjeve.



Saktësimi i sasive të depozituara/ të shkëmbyera do të bëhet mes palëve jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

4. KESH sh.a., në funksion të kapacitetit gjenerues (në rast të prurjesh në kaskadë) përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, njofton shoqërinë FTL sh.a mbi mundësinë e prodhimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.
5. Bazuar në pozitën e palëve për muajt paraardhës, energjia e llogaritur mbi të dhënat më sipër do të përbëjë:
 - i) energji të depozituar, është sasia që rezulton pozitive nga diferenca mes shumatores së prodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe blerjes në treg të parregulluar për mbulimin e humbjeve, me humbjet totale mujore në rrjetin e shpërndarjes sipas bilancit energjistik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.
 - ii) energji të shkëmbyer, është sasia që rezulton negative nga diferenca mes shumatores së prodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe blerjes në treg të parregulluar për mbulimin e humbjeve, me humbjet totale mujore në rrjetin e shpërndarjes sipas bilancit energjistik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.

Neni 3

Realizimi i transaksioneve

1. Sasia e tepërt e energjisë elektrike nga prodhimi i kaskadës së Drinit, pas ezaurimit të sasisë së energjisë së depozituar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse, i shitet “FTL” SH.A. nga “KESH” SH.A. për mbulimin e humbjeve me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
2. Nëse në përfundim të rakordimit vjetor mes palëve, evidentohet se humbjet janë mbuluar përtej sasisë së energjisë së depozituar nga FTL SH.A. në KESH sh.a., dhe kjo sasi nuk është pjesë e prodhimit të KESH sh.a., atëherë kjo sasi do të faturohet me çmimin mesatar të ponderuar të sigurimit të kësaj energjie nga KESH sh.a. në periudhën përkatëse.
3. Transaksionet e depozitimit dhe shkëmbimit të energjisë do të realizohen pa çmim por me bilance energjitike.
4. Transaksionet e shkëmbimit të energjisë do të realizohen në raportin: 1 (një) njësi e depozituar : 1 (një) njësi e kthyer.
5. Në rast se në fund të vitit, sasia e depozituar e energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi është më e madhe se ajo e kthyer për mbulimin e nevojave të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë KESH sh.a. do të kompensojë në vlerë këtë diferencë energjie, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë.

Neni 4

Faturimi dhe Pagesa

1. Në rastin e shitjes së humbjeve, në përputhje me nenin 3 pika 1 të kësaj kontrate, nga shoqëria KESH për FTL, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të Energjisë Elektrike të dakordësuar nga shitësi dhe blerësi për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes. Paraqitja e faturës do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës së livrimit të energjisë elektrike. Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe të dhënat shoqëruese që lidhen me faturimin.



2. Në përputhje me nenin 3 pika 5 të kësaj kontrate, shoqëria FTL brenda datës 10 te muajit pasardhës të lëvrimin të energjisë elektrike, duhet t'i dërgojë KESH informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi më shumë se ajo e kthyer për mbulimin e humbjeve në sistemin shpërndarjes.
Në fund të vitit kalendarik, Palët pas marrjes së të dhënave, rakordojnë detyrimin vjetor për tepëricën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe lëshojnë faturën tatimore brenda datës 10 të vitit pasardhës.
3. Pagesa e faturës nga ana e blerësit, do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të fatures.
4. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas legjislacionit në fuqi. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

Neni 5

Mos-Performanca për shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësisht të kërkesës për klientët universalë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkak të e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - b. pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
 - c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes.
 - d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.
2. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.
3. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.
5. Në rast të mos livrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslëvruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të lartë, nëse



ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palëvruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

6. Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

Neni 6

Personat e kontaktit

1. Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për FTL	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. Funksioni Drejtor Operacional/DTE Adresa Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ E-mail:	Z/Znj Drejtori i Departamentit të Operimit dhe Tregtimit Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/249 Mob:+ 355 697098777 Fax: + 355 4 2232046 E-mail:
Programimi	
Z/Znj Funksioni: Specialist/Drejtorja e Blerjes se Energjise ne treg te rregulluar/DTE. Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355 E-mail:	Z/Znj Drejtor i Drejtorise se Operacioneve Tregtare Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 355 69 4033490 Fax: + 355 4 2232046 E-mail
Back Office	
Z. Funksioni Drejtor i Departamentit Ekonomik Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 3556 E-mail:	Z/Znj Përgjegjës, Sektori i Administrimit të Kontratave Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 35568 6025827 Fax: + 355 4 2232046



E-mail:

Neni 7**Legjislacioni në Fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8**Parashikime Kalimtare**

1. Palët, me miratimin e kësaj kontrate, bazuar në parashikimet e pikës 2 të Nenit 15, të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022 të Këshillit të Ministrave, rakordojnë sasi të energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.
2. Rakordimi mes palëve i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe shërben si referencë për gjendjet e sasive të energjisë së depozituara/shkëmbyera të cilat do të rregullohen nga parashikimet e kësaj kontrate për vitin 2022.

Neni 9**Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme**

1. Kjo Kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe do t'i shtrijë efektet nga dt. 01.07.2022-31.12.2022.
2. Ajo mund të përfundojë, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 9

Kjo kontratë nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje të barazvlefshme, 3 (tre) kopje KESH sh.a. dhe 3 (tre) për FTL sh.a.

**ERGYS VERDHO****ADMINISTRATOR****ERINA REXHEPI****ADMINISTRATOR**



VENDIM

Nr. 338, datë 21.12.2022

**MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SHA
DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË
FURNIZOHEN NGA FSHU SHA”**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 47, 56, germa “f”, si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pjesës I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; kapitullit V, të “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 139, datë 15.8.2016, i ndryshuar; “Kodi i Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094 prot., datë 19.12.2022 “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 274, datë 27.10.2022, vendosi që: shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të rishikojnë bazën ligjore, nenet 1, 2, 9, 14 dhe 21, të kontratës së dërguar në ERE me shkresën e përbashkët të KESH sh.a., me nr. 4845/1 prot., datë 30.9.2022, dhe të FSHU sh.a., me nr. 6926/1 prot., datë 30.9.2022, kontratën me nr. 4845 prot., të KESH sh.a., datë 30.9.2022., dhe me nr. 6926 prot., të FSHU sh.a. datë 30.9.2022. VKM nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar, ka shpallur gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 31 dhjetor 2022.

- Shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. me shkresën nr. 1744-1 prot., datë 30.11.2022, dërguan në ERE kontratën tip, mes shoqërisë KESH – FSHU me nr. 5823/1 prot., datë 25.11.2022, të KESH sh.a. dhe nr. 6926/2 prot., datë 25.11.2022 të FSHU sh.a. me ndërhyrjet sipas konstatimeve dhe përmbajtjes së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 274, datë 27.10.2022.

- Një nga detyrat e lëna nëpërmjet vendimit të Bordit të ERE-s nr. 274/2022, në konstatimet e tij është dhe saktësimi i bazës ligjore të kontratës së referuar në ERE.

- Kontrata e ri sjellë në ERE nëpërmjet shkresës nr. 1744/1 prot., datë 30.11.2022, për KESH sh.a. me nr. 5823/1 prot., datë 25.11.2022 dhe për FSHU sh.a. me nr. 6926/2 prot., datë 25.11.2022, referon si bazë ligjore VKM-në nr. 620/2021, të ndryshuar me VKM-në nr. 757, datë 9.12.2021, si dhe VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022.

- Në shkresën e sipërcituar shoqëritë sqarojnë se: në draftin dërguar nëpërmjet shkresës nr. 4845/1 prot., datë 30.9.2022 të KESH sh.a. dhe nr. 6926/1 prot., datë 30.9.2022, të FSHU sh.a., parashikuan në seksionin e bazës ligjore vetëm aktet, të cilat në momentin e finalizimit të kontratës ishin në fuqi.

Nga ana e palëve është e qartë se për periudhën e rregulluar të marrëdhënies nga data 1.1.2022–31.12.2022, marrëdhënia juridike mes palëve ka qenë e rregulluar edhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 620/2021, i ndryshuar, por vendosja



në referencë e këtij akti në momentin kur fuqia juridike e tij ka humbur, u vlerësua se do të përbënte një pasaktësi në aspektin material ligjor.

Megjithatë palët theksojnë se për t'u përmendur është fakti se marrëdhënia mes palëve e rregulluar nëpërmjet VKM nr. 620/2021, e ndryshuar, është me të njëjtën frymë si edhe e rregulluar në VKM nr. 456/2022.

- Për sa më sipër sqaruar nga ana e shoqërive si dhe duke ndjekur arsyetimin ligjor se deri në hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, marrëdhënia juridike e shërbimit publik mes palëve është rregulluar me VKM-në nr. 620/2021, e ndryshuar sikurse cituar dhe në dispozitat kalimtare të VKM-së nr. 456/2022 e cila parashikon se me hyrjen në fuqi të këtij vendimi sasi të energjisë elektrike të depozituara/ shkëmbyera përgjatë gjithë vitit kalendarik, të rakordohen sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit për vitin ushtrimor 2022, vlerësohet se për vitin ushtrimor 2023 shoqëritë të sjellin ndryshimet e sqaruara si më lart të bazës ligjore të referuar në kontratë tip.

- Shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. nëpërmjet shkresës së përbashkët protokolluar me tonën me nr. 1744/1 prot., datë 30.11.2022, me lëndë: "Për dërgimin e kontratës tip, mes shoqërive KESH-FSHU, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 274, datë 27.10.2022", sqarojnë lidhur me konstatimin në vendimin nr. 274/2022 "...KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të bëjnë saktësimet përkatëse nëse kontrata e përcjellë në ERE është një kontratë tip që do të përdoret për çdo rast ndërmjet palëve apo është një kontratë vetëm për një periudhë të caktuar kohore", se: kanë bërë ndërhyrjet dhe kanë përcjellë nëpërmjet kësaj shkrese, kontratën tip për rregullimin e marrëdhënies së "shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal, FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve universalë **për periudhën kohore dd/mm/vvvv-dd/mm/vvvv.**"

- Për sa më sipër kjo detyrë e lënë në konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 274, datë 27.10.2022 është plotësuar dhe reflektuar në kontratën tip të ri sjellë për miratim.

- Nga ana e shoqërive, në kontratën tip të rishikuar bashkëlidhur këtij vendimi, janë reflektuar

të dhënat për referencë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë së prodhimit, ashtu edhe fusha për t'u plotësuar nga palët për periudhat përkatëse që do të rregullohen nga kontrata tip.

- Më konkretisht pika 2 e nenit 2 të draftkantatës tip ka ndryshuar nga: "2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2022 është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. 1394/1 prot., datë 16.2.2022, i ndryshuar dhe sipas këtij vendimi është 2.6 lekë/KWh për energji, e cila shërben për furnizimin nga FSHU-ja të klientëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët, 0.4 kv dhe 12 lekë/KWh për energji që shërben për furnizimin nga FSHU si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) të klientëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të mesëm 6/10/20 kv. "NW: "Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin VVVV është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. ____ prot., datë dd/mm/vvvv".

- Shoqëritë shprehen, se: lidhur me përcaktimin e çmimit për kategori klientësh dhe tarifimit me fasha konsumi mujore, referuar vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022.

"...nga ana e shoqërive është evidentuar se çmimi apo çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria e prodhimit të shoqëria e furnizimit universal, në bazë të përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 456/2022, të Këshillit të Ministrave është kompetencë e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë publike të prodhimit."

Duke marrë në konsideratë këtë parashikim nga ana e shoqërive ky vendim është referuar në nenin 2 të kontratës si e dhënë e cila përcaktohet për periudhën përkatëse që do të rregullojë.

- Për sa i përket konstatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 274/2022, se: "...Këto ndryshime prekin dhe elemente që lidhen me afatin e pagesave, e cila ndryshon nga 30 ditë në 45 ditë, po ashtu mënyrën e faturimit e cila ndryshon dhe për faktin se FSHU sh.a. shërben dhe si FMF-ja. Në këto kushte, palët KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të bëjnë me dije në ERE nëse ndryshimet në kontratë sjellin kosto shtesë për ato."

- Palët sqarojnë se: bazuar në përcaktimet e vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë së prodhimit nga ana e shoqërive është parashikuar në nenin 14, mekanizmi i faturimit të energjisë së livruar bazuar në parimet:



- i) faturim për energji të nominuar;
- ii) saktësim të faturimit sipas kategorisë së klientit të furnizuar;
- iii) saktësim të faturimit sipas tarifës së energjisë me fashë konsumi,

Pikat “ii” dhe “iii” nëse janë miratuar në vendimin e Asamblesë së Aksionareve.

Për sa më sipër palët kanë parashikuar në nenin 14 rregullimet e nevojshme kontraktore duke përcaktuar mënyrën dhe mekanizmat e faturimit.

Gjithashtu nga ana e shoqërive është përcaktuar edhe një afat prej 45 ditësh për pagesën e faturave, nga dita e fundit të muajit të livrimit.

- Në krahasim me afatin e mëparshëm të pagesave, përcaktuar në kontratën tip miratuar nga ERE me vendimin nr. 73, datë 22.4.2020, i ndryshuar, mes palëve është vendosur që afati i pagesës të jetë nga 30 ditë nga dita e faturimit, në 45 ditë nga dita e fundit e livrimit për muajin përkatës.

Ky afat vjen në linjë me detyrimet e KESH-it ndaj kreditorëve për blerje energjie, si dhe vjen si rrjedhojë e nevojave të mundshme për rakordime me fakt të energjisë së destinuar për kategori klientësh ose fashe konsumi mujore, duke mos sjell shtim të kostove për shoqërinë KESH apo shoqërinë FSHU.

- Nga shqyrtimi i kontratës të sjellë në ERE nëpërmjet shkresës së përbashkët protokolluar me tonën me nr. 1744/1 prot., datë 30.11.2022, vlerësohet që palët KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. të bëjnë këto ndryshime:

- Në bazën ligjore të kontratës të shtohen edhe këto akte ligjore:

- Vendimi nr. 584, datë 8.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”; i ndryshuar;

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;

- Vendimi nr. 215, datë 11.10.2018 i Bordit të ERE-s “Mbi transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.)”; i ndryshuar;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019 i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Në nenin 9 “Rakordimi i sasisë së energjisë të lëvruar për qëllim të furnizimit të klientëve”, pika 2 të ndryshojë: Me mbylljen e bilancit mujor të shoqërisë FSHU, jo më vonë se data 25 e muajit **pasardhës**, palët do të rakordojnë:

- Në shtojcën 2: “Sipas nenit 19, të kësaj kontrate...”, të ndryshohet “Sipas nenit 18 të kësaj kontrate...”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. (bashkëlidhur).

2. Me miratimin e kësaj kontrate, shfuqizohen aktet që bien në kundërshtim me të.

3. Kontrata e nënshkruar nga Palët, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë, KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund



ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti



Nr. _____ prot, datë ____/____/____

Nr. _____ prot, datë ____/____/____

**KONTRATË TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SH.A. DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL
(FSHU) SH.A., PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE UNIVERSALË PËR PERIUdhËN KOHORE**

dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv

E lidhur sot më datë _____.____._____ ndërmjet:

Shoqërisë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) SH.A., me objekt aktiviteti prodhimi i energjisë elektrike, shoqëri e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, e përfaqësuar nga Z. _____, Administrator i Shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., me objekt aktiviteti në: furnizimin me energji elektrike të klientëve universalë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë, përfaqësuar nga Z. _____, Administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Blerësi”

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore: neni 20 gërma h) e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Vendimi Nr. 620, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përbalimin e parandalimin e saj”, e ndryshuar me VKM Nr. 757, datë 9.12.2021, Vendimi i Bordit të ERE nr. 112, datë 08.07.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, Vendimi i Ministrit përgjegjës për Energjinë Nr. _____ prot., datë dd/mm/vvvv (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin vvvv.

**Në kushtet kur:**

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve universalë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimit nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike dhe vendimit të Bordit të ERE “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”,
- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në zbatim të Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” është e detyruar të furnizojë Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal.
- Deri në hyrjen në fuqi të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave, detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënie mes shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal rregulloheshin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar.
- Në dispozitat kalimtare të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022 të Këshillit të ministrave, parashikohet që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të rakordojnë sasinë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit, për vitin ushtrimor 2022.
- Çmimi për njësi i energjisë elektrike, për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti
- Ministri përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë) me vendimin nr. _____ prot., datë dd/mm/vvvv, i ndryshuar ka miratuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik nga shoqëria e prodhimit aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si më poshtë vijon:



NENI 1 QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo Kontratë (së bashku me Shtojcat apo anekset e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për periudhën kohore 1 Janar-31 Dhjetor.

NENI 2 SASIA E KONTRAKTUAR DHE ÇMIMI I SHITJES

1. Sasia e kontraktuar, nominuar për vitin, që Shitësi është i detyruar të furnizojë Blerësin, është e gjithë sasia e nevojshme për plotësimin e kërkesës së plotë të Blerësit, kjo referuar programeve mujore/javore/ditore/intra-day sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate.
2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin VVVV është ai i miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. _____ prot., datë dd/mm/vvvv.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Referencat në Kohë:** Referencat e kohës do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
2. **Përputhja me Aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut:** Kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.
3. **Sasia e kontraktuar** – sasija totale e energjisë referuar programeve mujore/ javore/ditore/intra-day të "FSHU" SH.A. për klientët universalë objekt i kësaj kontrate.
4. **Aneksi Nr. 1** – informacion paraprak parashikues për sasitë e plota vjetore të "FSHU" SH.A.
5. **Çmimi i kontratës:** Çmimi i përcaktuar sipas parashikimeve të VKM 456/2022,
6. **"Dita e Punës"** do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar;
7. **"Përgjegjësia për Balancimin"** shitësi dhe blerësi janë përgjegjës për të balancuar pozicionin e tyre në tregun e energjisë
8. **"Koha Qendrore Evropiane"** ose **"CET"** do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane sipas zbatimit;
9. **"Kapaciteti i Kontratës"** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MW;
10. **"Dëmet"** ka kuptimin e specifikuar në nenin 13. (**Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare**)
11. **"Pala që nuk përmbush detyrimet"** ka kuptimin e specifikuar në nenin 11 (**Pezullimi i Livrimit**);
12. **"Filial"** lidhur me një Palë do të thotë një Njësi e Kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo Njësi që Kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo Njësi direkt ose indirekt nën Kontrollin e përbashkët të një Pale
13. **"Pika e Livrimit"** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes



Palëve;



15. "Programi i Livrimit" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në avanse sipas rregullave përkatëse;
16. "Data e Pagesës" ka kuptimin e specifikuar në nenin 14 (Faturimi dhe Pagesa)
17. "Data e Hyrjes në Fuqi" ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate;
18. "Programi" ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3 dhe 7.2 (Përkufizimi i Programit) dhe "I Programuar" dhe "Programimi" do të interpretohen sipas kësaj;
19. "Taksë" do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;
20. Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

1. Blerësi, bazuar në kërkesën vjetore për energji, Aneksi Nr. 1 i kësaj kontrate, dhe në trendin e ngarkesës do t'i paraqesë Shitësit programin vjetor të ndarë me bazë mujore të ngarkesës së klientëve universalë, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike .
2. Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit të furnizimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë ditore dhe orare të ngarkesës.
3. Blerësi jo më vonë se dita e enjte e çdo jave do ti dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve universalë për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.
4. Blerësi brenda orës 12:00 të çdo dite do ti dërgojë Shitësit programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës sipas afateve të përcaktuara në Rregullat e Tregun Shqiptar të Balancimit.
5. Blerësi, brenda orës 15:00 do t'i dërgojë Shitësit përditësim të kërkesës për furnizimin e klientëve fundore për ditën D+2, me bazë orare me qëllim garantimin e furnizimit të plotë për periudhën vijuese.
6. Blerësi pas mbylljes së bilancit energjetik, por jo më vonë se data 10 e muajit duhet t'i dërgojë Shitësit informacionin mbi sasinë e energjisë së faturuar dhe informacione të tjera për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të kësaj kontrate.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi bazuar në programet vjetore/mujore/javore/ditore në day-ahead dhe intra-day do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së Blerësit.

NENI 6

DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE



1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimin dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike përkundrejt OST (deri sa nuk kanë një marrëveshje që rregullon përgjegjësinë e balancimit me të tretët).
2. **Nominimi (Livrimi dhe Pranimi):** Shitësi dhe blerësi do të nominojnë në Platformën e OST për nominimet. Bazuar në konfirmimet e bëra paraprakisht, çka përbën konfirmimin për livrimin (Shitësi) dhe pranimin (Blerësi) e energjisë elektrike objekt i kësaj kontrate. Sasia e programuar nga palët në sistemin DAMAS të OST është sasia kontraktuale për të cilën Blerësi do të paguajë Shitësit me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës.
3. **"Program"** sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit dhe pranimit, që përfshin programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës apo me OST, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e furnizimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

NENI 7

LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standarteve të parashikuara në Kodet dhe Rregullat në fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjisë Elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i furnizohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi i livrimit për ditën e nesërme duhet paraqitur në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet në fuqi.
3. **Dokumentacioni i Livrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:
 - do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe pranimit të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të Kontratës Individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike (referuar nominimit në Platformën e OST për nominimet).
4. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së energjisë së parashikuar në Kontratë deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
5. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në kufijtë e sistemit të transmetimit të OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

NENI 8

MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, **"Forcë Madhore"** për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore



(“Pala Pretenduese”), siç përcaktohet në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkak të mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

- a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - b) pezullimi nga OST-ja përkatëse i livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
2. **Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimit:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 8.3 (*Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore*), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjeshtë pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (*Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim*) nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasitë e pa livruara ose të pamarra.
3. **Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9

RAKORDIMI I SASISE SE ENERGJISE TE LEVRUAR PER QELLIM TE FURNIZIMIT TE KLIENTEVE

1. Shitësi dhe Blerësi jo më vonë se data 10 e muajit do të rakordojnë sasitë energjisë elektrike që kanë shkuar për furnizimin e klientëve universalë.
2. Me mbylljen e bilancit mujor të shoqërisë FSHU, jo më vonë se data 25 e muajit paraardhës, palët do të rakordojnë:
 - a) Sasinë e energjisë elektrike që nuk ka patur destinacion furnizimin e klientëve universalë, dhe ka patur destinacion mbulimin e humbjeve. Kjo sasi do të transferohet në marrëdhënien kontraktuale KESH-FTL, ndërsa për efekt të kësaj kontrate Shitësi do të bëjë një faturë sistemuese për FSHU.
 - b) Sasinë e energjisë elektrike e prodhuar nga prodhuesit me përparësi dhe e cila ka shkuar për FSHU. Kjo sasi, është sasia që rezulton pozitive nga diferenca mes shumatores së prodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe blerjes në treg të parregulluar për mbulimin e humbjeve, me



humbjet totale mujore në rrjetin e shpërndarjes sipas bilancit energjistik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.

NENI 10

MOS PERFORMANCE TE LEVRIMIT OSE PRANIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

- 1. Rasti i mos-performancës ana e shitësit:** Në atë shkallë që Shitësi - Pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike ("Pala Livruese") nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar/rakorduar për ditën në avang, intra-day, dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala Livruese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Pranuese") një shumë si kompensim për atë sasinë të palëvruar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie nga OST në tregun e parregulluar.
- 2. Rasti i mosrespektimit nga ana e blerësit:** Në rastin kur Blerësi ("Pala Pranuese") dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë elektrike të rakorduar për ditën në avang dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala pranuese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Livruese") një shumë si kompensim për dëmtimet si kompensim për atë sasi të papranuar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie nga KESH në tregun e parregulluar.
- 3. Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas këtij neni do të faturohen dhe paguhën sipas Nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

NENI 11

PEZULLIMI I LIVRIMIT

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të mundshme, nëse "Pala që nuk përmbush detyrimet" nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontratës, ose sipas kushteve të garancive nëse do aplikohen nuk arrin ta sigurojë, apo zëvendësojë vlerën e kërkuar sipas Kontratës, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet jo më parë se tre (3) Ditë Pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet (jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit sipas gjithë Kontratave specifike deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e tjera) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve, apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE.

NENI 12

KOHËZGJATJA

Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor të vitit VVVV.

NENI 13

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE



1. **Përfshirja e Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 8 (**Zhdëmtimet**), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("**Dëmet**"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate specifike) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mos pagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.
2. **Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:
 - (a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe
 - (b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumën e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate specifike përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 8 (**Zhdëmtimet për Paafitësinë për Livrim dhe Pranim**).
3. **Mos pagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - (a) mos pagesën e qëllimshme,
 - (b) mashtrimin; ose
 - (c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
4. **Detyra për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i Legjislacionit në Fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premtori që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

NENI 14

FATURIMI DHE PAGESA

1. **Fatura:** Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë elektronike sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të Energjisë Elektrike të levruar nga shitësi te blerësi sipas parashikimeve të nenit 9.
Për qëllime të zbatimit të pikës 2 të nenit 2 të kontratës, kur nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen nga shteti, janë përcaktuar çmime të shitjes së energjisë elektrike sipas destinacionit të përdorimit nga ana e shoqërisë së furnizimit (kategoria e klientit sipas nivelit të tensionit ku furnizohet dhe/ose fashës së konsumit mujor kur aplikohen çmime të ndryshme shitjeje), sasi të energjisë për furnizimin e kategorisë së klientëve dhe/ose tarifimit me fashë konsumi do të llogariten mbi raportin e kërkesës vjetore për furnizim. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.
2. **Përditësimi i faturës:** Shitësi mbi bazën e të dhënave të rakorduara ndërmjet palëve sipas parashikimeve të nenit 9 duhet të korrektojë faturat e lëshuara sipas pikës 1, duke lëshuar përkatësisht :
 - a) një faturë për energjinë faktike të levruar për klientët e ndryshëm nga klientët universalë,



- b) një faturë për energjinë faktike për klientët universalë për energji të faturuar mbi fashën me tarifë të rregulluar, nëse është aplikuar dhe
 - c) një faturë për sasinë e energjisë që rezulton si diferencë midis sasisë totale të programuar/faturuar sipas pikës 1 të këtij neni dhe energjisë faktike të livruar për klientët e ndryshëm nga klientët universalë dhe klientët universalë për konsum mbi fashën me tarifë të rregulluar, sipas pikës 2 a) dhe b).
3. **Pagesa;** Pagesa sipas faturës apo faturës së përditësuar, do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e fundit e livrimit Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.
4. **Vonesa në kryerjen e pagesës:** Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

NENI 15

TAKSAT DHE TATIMET

Çdo çështje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet në përputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16

TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve bëhet efektiv pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe miratimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

NENI 17

PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Për të adresuar riskun e çdo Pale, përse i përket mundësisë për përmbushjen e detyrimeve të palës tjetër, dhe për të siguruar përmbushjen e të gjithë detyrimeve që rezultojnë nga kjo Kontratë apo kontrata specifike, Palët mund të dakortësojnë, më parë apo në çdo kohë pas hyrjes në fuqi, ose në kohën pas nënshkrimit të kontratave specifike, ekzistencën e mbështetjes me garanci kredie dhe Garantues sipas kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të dakortësuara prej tyre

NENI 18

PERSONAT E KONTAKTIT

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:



Për Furnizuesit të Shërbimit Universal	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. _____ Adresa: Bulevandi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr.88, Tiranë Tel: _____ Cel: _____ E-mail: _____	Z/Znj. _____ Adresa: Rr.”Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel.: _____ Mob: _____ Fax: _____ E-mail: _____;
Programimi	
Z/Znj. _____ Adresa: Bulevandi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr.88, Tiranë Tel: _____ Cel: _____ E-mail: _____	Z/Znj. _____ Adresa: Rr.”Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel.: _____ Mob: _____ Fax: _____ E-mail: _____;
Back Office	
Z/Znj. _____ Adresa: Bulevandi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr.88, Tiranë Tel: _____ Cel: _____ E-mail: _____	Z/Znj. _____ Adresa: Rr.”Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel.: _____ Mob: _____ Fax: _____ E-mail: _____;

NENI 19

LEGJISLACIONI NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. **Legjislacioni në Fuqi:** Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Nëse palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet për zgjidhje EREs. Sa më sipër nuk përjashton të drejtën e palëve për të adresuar nëpërmjet Gjykatës zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të krijuar në interpretim apo kuptim të kësaj kontrate.

NENI 20

TË NDRYSHME

1. **Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, gjithë njoftimet, deklaratat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim (postë të shpejtë ose korrier). Çdo Palë



mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:

- a. nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së fundit të livrimit;
 - b. nëse dërgohen me postë, Ditën e 2^{te} të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5^{te} të Punës pas datës së postimit;
 - c. nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
2. **Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.
3. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Në rast se legjislacioni në fuqi sjell ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate, deri në miratimin nga ERE të këtyre ndryshimeve, legjislacioni i zbatueshëm do të prevalojë në kuptimin dhe interpretimin e këtyre dispozitave.

NENI 21

MIRATIMI I ERE-S, EFEKTET DHE ZGJIDHJA E PARAKOHSHME

1. Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor për vitin VVVV.
2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate.
3. Kjo kontratë Tip mund të ndryshohet vetëm me miratimin e EREs.

NENI 22

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” SH.A. “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A.

ADMINISTRATOR

ADMINISTRATOR



Shtojca 1: Programet e livrimit sipas Neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate



Shtojca 2: Sipas Nenit 19, të kësaj kontrate “Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të Palëve për regjistrimet telefonike”



ANEKSI NR. 1

Parashikimi i konsumit të kërkuar nga ana e FSHU



Ndërmjet shoqërive:

Me datë ____/____/____, KESH sh.a. ka livruar/nonimuar në sistemin Damas energjinë elektrike sipas raportit të mëposhtëm:

Data/jora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	TOTALE
01/ /2022																									
02/ /2022																									
03/ /2022																									
04/ /2022																									
05/ /2022																									
06/ /2022																									
07/ /2022																									
08/ /2022																									
09/ /2022																									
10/ /2022																									
11/ /2022																									
12/ /2022																									
13/ /2022																									
14/ /2022																									
15/ /2022																									
16/ /2022																									
17/ /2022																									
18/ /2022																									
19/ /2022																									
20/ /2022																									
21/ /2022																									
22/ /2022																									
23/ /2022																									
24/ /2022																									
25/ /2022																									
26/ /2022																									
27/ /2022																									
28/ /2022																									
29/ /2022																									
30/ /2022																									
31/ /2022																									
TOTALE																									

- Sasia totale e energjisë e nominuar në DAMAS _____
- Sasia e energjisë elektrike për efekt shkëmbimi/humbje _____
- Sasia e energjisë e nominuar nga FSHU SH.A. për:
 - Klientët universalë _____
 - Klientët e ndryshëm nga klientët universalë _____

Konfirmuar nga KESH:

(emer, mbiemer, firme)

Konfirmuar nga FSHU:

(emer, mbiemer, firme)

**KËRKESË**

Shtetasi Dhimitër Spiro kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të shtetasit Sotir Andon Papaspiro, i lindur më datë 20.7.1928 në Nivan, Gjirokastrë, dhe me vendbanimin e fundit në qytetin e Durrësit.

KËRKUES
Dhimitër Spiro

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë